



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 10 (827814)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 10 mars 2023

Presidenti Bajram Begaj, vizitë në selinë e NATO-s

Presidenti Bajram Begaj, së bashku me delegacionin që e shoqëronte, u prit në selinë e NATO-s nga Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg, i cili mes të tjerash vlerësoi Shqipërinë për kontributin e saj, si një vend që luan një rol kyç në promovimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit në të gjithë Ballkanin Perëndimor, një rajon me rëndësi strategjike për NATO-n. Në Konferencën e përbashkët për shtyp, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg theksoi se: "Është e mrekullueshme të kesh një

President të Shqipërisë që e njeh NATO-n aq mirë sa ti, sepse ju keni qenë shefi i Shtabit i Mbrojtjes i një vendi dhe ne të gjithë e dimë se ju e njihni këtë Aleancë në shumë e shumë mënyra të ndryshme dhe kjo është një forcë për të gjithë ne dhe për të gjithë organizatën". Stoltenberg tha se Shqipëria është një aleate e çmuar me një histori të gjatë në rritje për të mbështetur aleatët dhe partnerët e NATO-s. "Ju kontribuoni në forcat shumëkombëshe të NATO-s në Letoni dhe Bullgari, duke ndihmuar

në parandalimin e çdo agresioni. Forcat tuaja shërbejnë në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë dhe në misionin tonë për ndërtimin e kapaciteteve në Irak. Muajin e kaluar vendi juaj iu përgjigj me shpejtësi tërmetit shkatërrues në Turqi me dërgimin e personelit mjekësor dhe të kërkim-shpëtimit". Shefi i NATO-s tha se Shqipëria gjithashtu luan një rol kyç në promovimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit në të gjithë Ballkanin Perëndimor që është një rajon me... >>> faqe 3



Ministri Peleshi: Progres drejt rritjes së numrit të grave në sektorët prioritarë siç është siguria kibernetike, ku 50% janë gra dhe vajza



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: 8 Marsi është mbi të gjitha arritje e të pamundurës

Për ju koleget e mia që shërbeni në Forcat e Armatosura! Në këtë ditë të shënuar, dëshiroj t'ju drejtohem juve, jo vetëm si zëvendëshefe e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e si gjenerale, por si njëra prej jush, si grua, kolege, nënë e motra juaj: "Gëzuar festën e 8 Marsit, Ditën Ndërkombëtare të Gruas, shëndet e lumturi paçi në çdo aspekt të jetës tuaj familjare e shoqërore!" Që nga nëntori i vitit 1977, Kombet e Bashkuara (UN), 8 marsin e kanë njohur botërisht si "Ditën e Gruas", ditë kur të drejtat e gruas u...



>>> Faqe 7

Gjeneral Kingji priti në takim komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të SFARSH, gjeneral brigade Arben Kingji priti në një takim të veçantë komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa J. Hou. Gjeneral Kingji, pas urimit të mirëseardhjes për gjenerale Hou, shprehu konsideratat më të larta për mbështetjen dhe kontributin që japin SHBA-të nëpërmjet programeve të partneritetit dhe bashkëpunimit, në ndihmë të përmirësimit të kapaciteteve të Forcave të Armatosura. Takimi ndërmjet gjeneral brigade Kingjit dhe gjeneral brigade Lisa Hou...



>>> Faqe 4

Gjeneral brigade Bilbil Bitri pret Komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou

Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri priti në një takim Komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou. Gjeneral Bitri vlerësoi bashkëpunimin me GKNJXH, në drejtim të transformimit të AFA-së sipas modelit të Akademisë Amerikane "West Point" (AWP) si dhe mbështetjen për zhvillimin e trupës së n/officerëve. Ai theksoi se: "Stërviçjet e përbashkëta me studentët ushtarakë, është një platformë e suksesshme për konsolidimin e programit ushtarak të studentëve por edhe zhvillimin në praktikë..."



>>> Faqe 5

Presidenti Bajram Begaj, vizitë në selinë e NATO-s

Presidenti Bajram Begaj, së bashku me delegacionin që e shoqëronte, u prit në selinë e NATO-s nga Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg, i cili mes të tjerash vlerësoi Shqipërinë për kontributin e saj, si një vend që luan një rol kyç në promovimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit në të gjithë Ballkanin Perëndimor, një rajon me rëndësi strategjike për NATO-n.

Në Konferencën e përbashkët për shtyp, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg theksoi se: “Është e mrekullueshme të kesh një President të Shqipërisë që e njeh NATO-n aq mirë sa ti, sepse ju keni qenë shefi i Shtabit i Mbrojtjes i një vendi dhe ne të gjithë e dimë se ju e njihni këtë Aleancë në shumë e shumë mënyra të ndryshme dhe kjo është një forcë për të gjithë ne dhe për të gjithë organizatën”.

Stoltenberg tha se Shqipëria është një aleat e çmuar me një histori të gjatë në rritje për të mbështetur aleatët dhe partnerët e NATO-s. “Ju kontribuoni në forcat shumëkombëshe të NATO-s në Letoni dhe Bullgari, duke ndihmuar në parandalimin e çdo agresioni. Forcat tuaja shërbejnë në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë dhe në misionin tonë për ndërtimin e kapaciteteve në Irak. Muajin e kaluar vendi juaj iu përgjigj me shpejtësi tërmetit shkatërrues në Turqi me dërgimin e personelit mjekësor dhe të kërkim-shpëtimit”. Shefi i NATO-s tha se Shqipëria gjithashtu luan një rol kyç në promovimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit në të gjithë Ballkanin Perëndimor që është një rajon me rëndësi strategjike për NATO-n. “Unë mirëpres gjithashtu rolin tuaj aktiv në promovimin e politikës së dyerve të hapura të NATO-s dhe përgëzoi Shqipërinë që ratifikoi kaq shpejt Protokollin e Anëtarësimit për Finlandën dhe Suedinë. Kjo tregon se dera e NATO-s mbetet e hapur dhe se ne mbrojmë të drejtën e çdo kombi për të zgjedhur rrugën e tij”, - tha ai. “Të gjitha këto kontribute tregojnë përkushtimin e fortë të Shqipërisë ndaj Aleancës sonë dhe NATO është e përkushtuar ndaj Shqipërisë. Aleatët qëndruan me ju pas sulmeve kibernetike vitin e kaluar dhe ekspertët e NATO-s



dhanë mbështetje urgjente”.

Stoltenberg theksoi investimin në bazën Ajrore të Kuçovës, e cila do të rrisë sigurinë e hapësirës ajrore shqiptare.

Duke folur mbi luftën brutale të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, Sekretari i Përgjithshëm tha se Presidenti Putin po fillon ofensiva të reja dhe valë sulmesh me raketa vdekjeprurëse. “Përgjigja jonë duhet të jetë vazhdimi i ofrimit të Ukrainës me atë që i nevojitet për të mbizotëruar. Aleatët po rriten me mbështetje të paprecedentë dhe unë mirëpres premtimin e Shqipërisë për ndihmë”, - nënvizoi shefi i NATO-s. “Ne duhet të vazhdojmë mbështetjen tonë për aq kohë sa të duhet. Sot diskutuam gjithashtu angazhimin e NATO-s ndaj Ballkanit Perëndimor”.

Roli i NATO-s në dialogun Kosovë-Serbi

Duke folur për rolin e NATO-s në Kosovë, Sekretari i Përgjithshëm theksoi që NATO ka qenë e pranishme në Kosovë për shumë vite dhe falënderoi gjithashtu Shqipërinë për kontributin e saj në praninë e NATO-s atje. “Prania e KFOR-it, forca e NATO-s ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në promovimin e stabilitetit dhe paqes dhe sigurimin e lirisë së lëvizjes për të

gjitha grupet në Kosovë dhe aleatët janë të përkushtuar të vazhdojnë të kontribuojnë dhe të sigurojnë praninë e vazhdueshme të KFOR-it në Kosovë, që do të thotë se kjo është një prani e konsiderueshme e NATO-s që është dëshmuar jashtëzakonisht e rëndësishme për shumë vite”. NATO punon krah për krah me BE-në në Kosovë

dhe prania e trupave të NATO-s të KFOR-it mbështet përpjekjet diplomatike të Bashkimit Evropian. “Mirëpres bisedimet e fundit që u mbajtën këtu në Bruksel, si pjesë e dialogut të lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe NATO do të vazhdojë të mbështesë plotësisht dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit lehtësuar nga



BE, sepse ne besojmë se kjo është e vetmja rrugë e qëndrueshme përpara drejt zgjidhjes dhe stabilitetit në Kosovë”, - tha ai. Kjo është një mundësi historike për paqe të qëndrueshme, nga e cila mund të përfitojë i gjithë rajoni. “Prandaj, mirëpres qasjen konstruktive. Është e rëndësishme që të gjitha palët tani të tregojnë fleksibilitet dhe gatishmëri për kompromis dhe në fakt po tregojnë një vullnet të vërtetë, për të gjetur një mënyrë, për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme”. Ai theksoi se çdo zgjidhje, duhet të marrë parasysh në respektimin e plotë të të drejtave të njeriut, vlerave demokratike dhe shtetit të së drejtës, reformat e brendshme dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë. Ai tha se “NATO është prezente në Kosovë, ne po e marrim situatën shumë seriozisht dhe ne mbështesim fuqishëm dialogun e lehtësuar nga BE-ja”.

Nga ana e tij Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj tha se plani evropian është një hap pozitiv dhe se Shqipëria mbështet

rrugëtimin e Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, duke përfshirë aleancën e NATO-s, zgjerimi i së cilës sipas tij, është shumë me rëndësi në këto kohë sfida. “Plani evropian për normalizimin e marrëdhënieve është një hap pozitiv që duhet të qendërohet në njëohjen reciproke ndërmjet dy shteteve. Vlerësoj maksimalisht angazhimin dhe përkushtimin e NATO-s në rajon dhe misionin e KFOR-it si një histori suksesi. Jemi duke kaluar kohë sfida të mëdha të cilat kërkojnë vendime të guximshme dhe të drejta. Në këtë kontekst është në bindjen time se është më se e justifikueshme për të konsideruar anëtarësimin e Kosovës në aleancën euroatlantike”, - tha zoti Begaj.

“Përfundimi i procesit të anëtarësimit është një prioritet kryesor për NATO-n dhe për mua, dhe ne po bëjmë përpunim”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për gazetaret në konferencën e përbashkët me presidentin shqiptar Begaj.

“Kohët e fundit jam takuar me Presidentin Erdogan dhe ramë dakord të rifillojmë bisedimet. Do të ketë një takim këtu në Bruksel, ku do të trajtojmë zbatimin e atij memorandumi trepalësh të mirëkuptimit që u ra dakord nga Finlanda, Suedia dhe Turqia në samitin e NATO-s verën e kaluar. Unë gjithashtu do të shkoj sot më vonë në Suedi dhe kam parë raportet e delegacionit parlamentar hungarez që sapo ka vizituar Suedinë, dhe ata po dërgojnë mesazhe

pozitive dhe rekomandojnë ratifikimin. Pra, sigurisht, ne kemi ende një rrugë për të bërë, por ne po bëjmë përpunim dhe ky mbetet deri tani procesi më i shpejtë i ratifikimit në historinë moderne të NATO-s”. Duhet të kujtojmë se Finlanda dhe Suedia aplikuan në maj, vitin e kaluar, në qershor u ftuan nga të gjithë aleatët e NATO-s, përfshirë Turqinë dhe Hungarinë, të cilët ftuan Finlandën dhe Suedinë dhe të gjithë aleatët e NATO-s, përfshirë Hungarinë dhe Turqinë, nënshkruan protokollin e anëtarësimit.

Deri më tani, 28 nga 30 aleatët kanë ratifikuar protokollin përveç Turqisë dhe Hungarisë. “I bëj thirrje gjithashtu, dy aleatëve të mbetur, Hungarisë dhe Turqisë ta bëjnë këtë sa më shpejt të jetë e mundur. Parlamenti hungarez ka shpallur planin për ta bërë këtë deri në fund të muajit, dhe më pas me delegacionin që viziton Suedinë, duke dërguar një mesazh pozitiv, mendoj se po bëjmë progres dhe po i afrohem ratifikimit edhe në Hungari”.

Ministri Peleshi: Progres drejt rritjes së numrit të grave në sektorët prioritarë siç është siguria kibernetike, ku 50% janë gra dhe vajza

Një ekip i Gardës Kombëtare të New Jersey - it, së bashku me gra dhe vajza të Forcave të Armatosura të Shqipërisë organizuan në Tiranë Forumin "Sfidat e sigurisë në Evropë - Gratë, paqja dhe siguria". Synimi i këtij aktiviteti, me rastin e Festës së Gruas, është fuqizimi i rolit të grave ushtarake, si pjesë e Forcave të Armatosura. Në forumin që shërbeu edhe si një trajnim për gratë ushtarake për çështje që lidhen me sigurinë e paqen, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi falënderoi Gardën Kombëtare të New Jersey - it.

Z. Peleshi theksoi përparimin që është bërë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, duke hequr kufizimin e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në FA. "Sfidat e sigurisë janë bërë më të mprehta, për më tepër për një rajon si rajoni ynë i Ballkanit Perëndimor, i cili është një rajon ende i brishtë. Kemi një direktivë të OKB-së për barazinë gjinore, mbi të cilën në 2022 ne hartuam edhe Planin e Barazisë Gjinore në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes për një periudhë 10 - vjeçare. Ne kemi bërë një progres të rëndësishëm në aspektin e dokumenteve, sepse deri në vitin 2022 ne kemi pasur një kufizim, që tanimë duket absurd, dhe i tillë ka qenë, pra në Forcat e Armatosura nuk duhet të kishte më shumë se 15% gra. Tani ky kufizim është hequr. Në planin tonë nuk ka kufizim. Kemi rritje të konsiderueshme të pjesëmarrjes në FA-së, rritje të titullimit të oficerëve të reja, të rritjes së numrit të grave e vajzave në sektorët shumë prioritarë siç është siguria kibernetike, ku 50% janë gra



dhe vajza", - u shpreh ministri Peleshi.

E pranishme në forum, ambasadorja amerikane Yuri Kim, vlerësoi Shqipërinë si aleatë të denjë të SHBA-ve. "Për ne, për SHBA-të, është një parim i qartë. Ne duam të jemi bashkë me vendet e tjera që besojnë si ne, që fëmijët tanë duhet të jetojnë në një

botë të lirë, të hapur, të sigurt dhe që përparon. Dhe për ne nuk ka një aleat më të mirë se sa Shqipëria. Ne jemi krenarë t'ju kemi aleatë në NATO. Ne jemi krenarë të shohim përparimin tuaj në rrugën drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian", - u shpreh ambasadorja Kim. Duke kujtuar



thënien e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, "Bashkimi bën fuqinë", ambasadorja tha se Shqipëria dhe SHBA-të duhet të qëndrojnë së bashku dhe ky është një komponent kyç në përballimin e sfidave të sigurisë në të gjithë botën.

Ndërsa komandantja e Gardës

Kombëtare të New Jersey - it, gjeneral brigada Lisa Hou foli për sfidat e sigurisë në Evropë që vijnë jo vetëm për shkak të luftës në Ukrainë. Sipas saj, shumë shtete po përballen sot me sfida në sigurinë kibernetike, ndaj edhe vuri theksin në forcimin e bashkëpunimit mes të gjitha vendeve të NATO-s.

Ministri Peleshi: Për të arritur atë që meritojnë gratë dhe vajzat, duhet t'i kushtojmë kauzës të tyre çdo ditë, po aq vëmendje e po aq rëndësi sa i kushtojmë çdo 8 Mars

Në ditën e 8 Marsit, ministri Peleshi uroi femrat në uniformën ushtarake:

"Nderojmë të gjitha vajzat e gratë e guximshme që shërbejnë në Forcat e Armatosura. Përkushtimi dhe sakrificat juaj na frymëzojnë të gjithëve. Angazhimi juaj i palëkundur për punën është vërtet i admirueshëm ndaj dhe ju falënderoj për shërbimin tuaj të pakursyer.

Gëzuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas për të gjitha vajzat, gratë, nën! Një urim i veçantë për të gjitha femrat në uniformën ushtarake, për kontributin e tyre të pakursyer, krahu për krahu burrave pa iu stepur asnjë rreziku!

Ndërkohë që gratë kanë arritur të fitojnë sot një përfaqësim e fuqi për të ndikuar në fatet e vendit, ana tjetër e medaljes është që gra e vajza anëmbanë vendit vazhdojnë të përballen me dhunë, abuzim e diskriminim.

Dua t'i bëj thirrje çdo gruaje e çdo vajze që të vazhdojmë të punojmë, të luftojmë, sepse një shoqëri më e drejtë për gratë, është një shoqëri më e mirë për të gjithë. Dhe të mos harrojmë për asnjë moment, që e vetmja mënyrë se si mund të arrihet ajo që meritojnë gratë dhe vajzat, është t'i kushtojmë kauzës të tyre çdo ditë, po aq vëmendje e po aq rëndësi, sa i kushtojmë në 8 Mars".



Ministri Peleshi, komandantja e Gardës së New Jersey-it dhe ambasadorja Yuri Kim, vizitë në pikën e rekrutimeve në qendër të Tiranës

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi së bashku me ambasadorën amerikane Yuri Kim dhe komandantën e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigada Lisa Hou, e cila ndodhet në Shqipëri vizituan pikën e rekrutimeve të ngritur në qendër të Tiranës. Komandantja e Gardës Kombëtare të New Jersey-it dhe ambasadorja Yuri Kim diskutuan me pjesëtarë të FA-së dhe të rinjtë që kanë shprehur interes për të aplikuar për 400 pozicionet e lira dhe për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, teksa shpjegoi reformat e ndërmarrta vitet e fundit në Forcat e Armatosura dhe në fushën e mbrojtjes, vlerësoi mbështetjen dhe partneritetin strategjik me SHBA-të. "Jemi duke reformuar edhe infrastrukturën, por edhe sistemin e shpërblimeve, pagesave, trajtimit social të ushtarakëve tanë. Kështu që ka shumë arsye se përse të rinjtë e sotëm ia vlen ta konsiderojnë dhe të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura dhe Akademisë së FA-së. Unë jam i lumtur që jam sot me dy përfaqësues të partnerit tonë strategjik që është më pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me ambasadorën Yuri Kim, por edhe me gjeneralen Hou nga Garda e New Jersey-it. Me Gardën e New Jersey-it kemi celebruar 20-vjetorin e partneritetit. Një mbështetje e gjithanshme.

Një nga mbështetjet është edhe ngritja e kapaciteteve të pilotëve tanë dhe teknikëve për flotën e re të helikopterëve "Black Hawk" që ne jemi duke ngritur. Së shpejti presim helikopterët e parë. Jemi me fat që kemi partnerë të tillë, aq më tepër kur



siguria dhe mbrojtja është një prioritet i dorës së parë për të gjithë globin", - u shpreh ministri Peleshi.

Gjeneral brigada Lisa Hou vlerësoi gjithashtu bashkëpunimin me Shqipërinë. "Kemi 20 vjet partneritet dhe ai bëhet më i fortë çdo vit. Ne trajnohemi së bashku, zhvillohemi së bashku dhe e bëjmë njëri-tjetrin më të fortë", - tha Komandantja e Gardës Kombëtare të New Jersey-it.

Nga ana e saj, ambasadorja Yuri Kim bëri një thirrje për të gjithë të rinjtë shqiptarë të bëhen pjesë e FA-ve, për t'i shërbyer vendit. "Forcat e Armatosura janë shumë të rëndësishme për çdo vend, përfshirë

SHBA-të dhe Shqipërinë. Shpresojmë që njerëzit më të mirë të afrohen për t'i shërbyer vendit. Kështu që kjo fushatë rekrutimesh është shumë impresionuese", - u shpreh ambasadorja amerikane Yuri Kim.

I gjithë muaji mars do të jetë muaji i rekrutimeve për pozicionet ushtar/detar aktiv në Forcat e Armatosura.

Ministria e Mbrojtjes ka hapur aplikimet në Qendrën e Personel-Rekrutimit, por edhe në pikën e ngritur në qendër të kryeqytetit për t'u dhënë mundësinë të gjithë të rinjve të përfitojnë nga 400 pozicionet e lira, duke garantuar trajtimin të mirë financiar dhe social.

Gjeneral Kingji priti në takim komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji priti në një takim të veçantë komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa J. Hou.

Gjeneral Kingji, pas urimit të mirëseardhjes për gjenerale Hou, shprehu konsideratat më të larta për mbështetjen dhe kontributin që japin SHBA-të nëpërmjet programeve të partneritetit dhe bashkëpunimit, në ndihmë të përmirësimit të kapaciteteve të Forcave të Armatosura. Takimi ndërmjet gjeneral brigade Kingjit dhe gjeneral brigade Lisa Hou u fokusua në marrëdhëniet dypalëshe të bashkëpunimit ushtarak. Gjenerale Hou u njoh mbi ecurinë e procesit të zhvillimit dhe modernizimit të mëtejshëm të FARSH-së në pajisje, teknikë, infrastrukturë, arsimimin ushtarak, mbrojtjen kibernetike, si dhe bashkëpunimin në fushën e stërvitjes dhe trajnimit të përbashkët.

Fokusi i takimit bilateral ishte thellimi i bashkëpunimit në interes të trajnimit të mëtejshëm të personelit, kryesisht në përdorimin e teknikës së re të armatimit, mbrojtjes kundër armëve të dëmtimit në masë, në fushën e zbulimit, si dhe në përmirësimin e të gjithë procesit të mirëmbajtjes logjistike në Forcat e Armatosura. Gjeneral brigade Lisa J. Hou, pasi vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin ushtarak dypalësh si një ndër partneritetet më të suksesshme që



ka Garda Kombëtare e New Jersey-it, siguroi rritjen e mbështetjes së mëtejshme në fushat në të cilat Forcat e Armatosura kanë nevojë. Vizita e gjeneral brigade Hou përkon me aktivitetin "Women in Military" nga ekipi amerikan i Gardës Kombëtare të

New Jersey-it, 05 - 10 mars 2023, si dhe me pjesëmarrjen e pesë ekipeve të ndryshme të trajnimit nga Garda Kombëtare në fushat e arsimimit, shëndetësisë, mbrojtjes kundër-kimike, zbulimit dhe mbrojtjes kibernetike.



Hapet Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM-13)

Në sallën e auditoriumit "Gjeneral Enrico Tellini", në Garnizonin "Skënderbej", Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë organizoi ceremoninë e hapjes së Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM-13), me pjesëmarrjen e zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, gjeneralëve, atashëve ushtarakë të akredituar në Shqipëri, drejtorëve dhe ushtarakëve të tjerë të lartë të Shtabit të Përgjithshëm, etj.

Zëvendës komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Emëror Hajdarasi në fjalën e tij të hapjes uroi pjesëmarrësit në kurs nga FARSH, Institucionet e Sigurisë në vend, vendet e rajonit dhe ato aleate për fillimin e kursit dhe falënderoi vendet për dërgimin e përfaqësuesve pjesëmarrës në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Në fjalën e rastit, kolonel Hajdarasi tha: "Si një prirje pozitive e bashkëpunimit, kursi është krijuar për t'u ofruar studentëve tanë njohuritë, të kuptuarit dhe mjetet e nevojshme që ata të bëhen komandantë, politikëbërës dhe menaxherë krijues dhe proaktivë. Gjatë këtij kursi ka shumë çështje për të diskutuar, vlerësuar dhe nxjerrë mësim, për shkak të një ndryshimi total të mjedisit të sigurisë të shkaktuar një vit më parë, që kur Rusia nisi pushtimin e saj ndaj Ukrainës, konflikti më i madh në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Arritjet e këtij kursi nuk mund të kuptohen pa kontributin e lektorëve nga Kolegji i Mbrojtjes i NATO-s, Kolegji Baltik, Qendra "Marshall", Kolegji i Luftës së Ushtrisë Amerikane dhe Instituti për Studime Globale në Romë, Forcat e Armatosura Shqiptare dhe Institucionet Shqiptare të Sigurisë.



Duke përfutur nga ky rast, dëshiroj t'i falënderoj të gjithë për mbështetjen e tyre për konsolidimin dhe përparimin e këtij kursi. Ne jemi mjaft optimistë në përmbushjen e objektivave të kursit, pasi kemi mbështetje të plotë nga institucionet shqiptare, veçanërisht nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i FA-së si dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Falënderime të veçanta shkojnë për pjesëmarrësit e huaj në këtë kurs, të cilët vijnë nga: Bullgaria, Gjeorgjia, Greqia, Italia, Kosova dhe Maqedonia e Veriut.

Më pas përshëndeti zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e cila në fjalën e saj u shpreh: "Ndihehem nderuar të jem sot në ceremoninë e

hapjes së kursit të 13-të të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, dua të falënderoj lidhshpërisht ushtarak të shteteve që iu përgjigjen në formë pozitive ftesës për dërgimin e përfaqësuesve në këtë kurs, duke i sjellë më afër ushtarakët me shoqërinë civile, kjo është më e rëndësishme në mjedisin e sigurisë që po jetojmë. Kam besimin tek lektorët dhe stafi akademik, të cilët do ta bëjnë këtë kurs të larmishëm dhe mjaft praktik. Shoqëria jonë ka nevojë për lidhshpërisht tuaj. Në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes marrin pjesë 15 ushtarakë të lartë nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë, Bullgarisë, Gjeorgjisë, Greqisë, Italisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut si dhe përfaqësues nga institucione në vartësi të Ministrisë së Brendshme, të Parlamentit dhe Presidencës.



AFA: Gëzuar 7 Marsin! Përrulësisht mirënjohës!

Me rastin e 7 Marsit, stafi akademik i AFA-së u përshëndet me vlerësim dhe mirënjohje në emër të komandantit të këtij institucioni, gjeneral brigade Bilbil Bitri, nga zëvendës dekanja e AFA-së Etleva Smaçi dhe zëvendëskomandanti i AFA-së, kolonel Arben Toska.

Në ceremoninë e organizuar në nder të kontributit disavjeçar të pedagogëve u shpërndanë buqeta me lule. “Urime dhe mirënjohje në këtë ditë feste për secilin anëtar të stafit pedagogjik të AFA-së. Faleminderit për përkushtimin, dedikimin dhe durimin që manifestoni në përcjelljen e dijeve e vlerave njerëzore tek brezat e Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të së nesërme. Gëzuar 7 Marsin! Përrulësisht mirënjohës!”, - do të shprehnin në fjalën e tyre zëvendës dekanja e AFA-së Etleva Smaçi dhe zëvendëskomandanti i AFA-së, kolonel Arben Toska.



Gjeneral brigade Bilbil Bitri pret Komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou

Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri priti në një takim Komandanten e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, gjeneral brigade Lisa Hou.

Gjeneral Bitri vlerësoi bashkëpunimin me GKNJXH, në drejtim të transformimit të AFA-së sipas modelit të Akademisë Amerikane “West Point” (AWP) si dhe mbështetjen për zhvillimin e trupës së n/officerëve. Ai theksoi se: “Stërvitjet e përbashkëta me studentët ushtarakë, është një platformë e suksesshme për konsolidimin e programit ushtarak të studentëve por edhe zhvillimin në praktikë të pjesës së ‘Zhvillimit të karakterit’”. Ato kontribuojnë në rritjen e ndërveprueshmërisë së forcave, motivimin e pjesës studentore, dhe konsolidimin dhe zhvillimin cilësor të stërvitjes. Modeli i zhvillimit të këtyre stërvitjeve është një eksperiencë jo vetëm për stafin mësimdhënës por edhe një eksperiencë që do të transmetohet nga studentët, kur ata të jenë liderë në repartet e FARSH-it. Gjeneral Bitri, vlerësoi mbështetjen e trajnimit të instruktorëve në institucionet e GKNJXH, i cili është gur themeli për suksesin në zhvillimi e stërvitjes dhe programit mësimor sipas modelit amerikan. Kontingjenti i instruktorëve të trajnuar në SHBA do të jetë një vlerë e shtuar për FARSH/AFA për zhvillimin e stërvitjes së vogël, një domain që duhet të zotërohet nga trupa e nënoficerëve.

Gjithashtu, u vlerësua mbështetja për zhvillimin e trupës së n/officerëve, sidomos bashkëpunimi me Qendrën e Arsimimit profesional të nënoficerit. Bashkëpunimi me këtë qendër ka qenë i gjithanshëm, që nga mësimdhënia deri në zhvillimin e kurrikulave dhe doktrinaeve për n/officerët. Eksperienca e fituar në këto kurse, është transferuar dhe shumëfishuar në repartet e FARSH nëpërmjet trupës së n/officerëve.

Gjeneral brigade Hou gjithashtu



vlerësoi bashkëpunimin me AFA-në dhe FARSH, i cili ka pasur një rritje të konsiderueshme në vitet e fundit. Ajo shprehu gatishmërinë për vijimin

e këtij bashkëpunimi në të ardhmen dhe theksoi se AFA është në rrugën e duhur drejt transformimit dhe arritjes së objektivave.



AFA, fituese e 4 kupave në 5-garëshin mes FT dhe KM

Në Regjimentin ROS batalioni Special/ Komando, midis forcave u zhvillua 5-garëshi Ushtarak, në të cilin ekipi i AFA-së i dominoi të gjitha garat. Dita e parë ishte në disiplinën e qitjes, ku ekipi i AFA-së zuri vendin e parë, duke lënë mbraja FT; Dita e dytë Brez-Kalitje ku ekipi i AFA-së zuri vendin e parë si dhe vendin e dytë si individ në Brez-Kalitje, major Bledar Mesi me rezultat 3.23; Dita e tretë Granad, ku ekipi i AFA-së zuri vendin e parë; Dita e katërt vrapim 8 km, ku ekipi i AFA-së zuri vendin e parë si dhe në vend të parë si individ major Bledar Mesi me rezultatin 27min 56 sek si dhe vendin e dytë studenti Përparim Gashi me rezultatin 29min 06 sek. Në përfundim AFA u shpall Kampion.

Ekipet pjesëmarrëse në 5-garëshin Ushtarak:

- AFA
- FT
- KM



Anija "Lissus" dhe një ekip efektivash të Forcës Detare do të jetë pjesë e operacioneve të përqendruara (FOCOPS) të NATO, në detin Mesdhe.

Në ceremoninë e përcjelljes së ekuipazhit, zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu u shpreh se: "me këtë mision Forca Detare rikthehet të kontribuojë si faktor i rritjes së sigurisë detare, pas një angazhimi të suksesshëm trevjeçar nga viti 2016 - 2019, në aktivitetin e NATO-s "Sea Guardian" në detin Egje, ku bëri të mundur dhënien e ndihmës mbi 1 800 personave, në rrezik për jetën. Ky është një tregues i qartë për rolin e Shqipërisë si një faktor stabiliteti dhe sigurie në rajon dhe më gjerë.

Ndryshe nga misioni i kryer në vitin 2016 - 2019 në detin Egje, që kishte karakter humanitar, kjo është hera e parë që Forca jonë Detare angazhohet në një operacion të mirëfilltë të rritjes së sigurisë detare", - u shpreh gjeneralmajor Manushaqe Shehu.

Më tej në fjalën e saj, zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, u shpreh e bindur se efektivët e anijes do të tregojnë profesionalizëm, përkushtim dhe korrektësi gjatë kryerjes së detyrave. Në ceremoninë e përcjelljes së trupave morën pjesë edhe komandantët e forcave të ndryshme.

Anija "Lissus" e Forcës Detare nisët me mision në detin Mesdhe, si pjesë e operacioneve të NATO-s



Në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse hapet kursi EOD, niveli I

Në Qendrën Stërvitore të KM, u hap kursi i njëmbëdhjetë EOD i nivelit të parë, me efektivë nga Forca Tokësore, Garda e Republikës, Policia Ushtarake dhe Komanda Mbështetëse.

Ky është një kurs funksional dhe ofron njohuri për oficerët, nënoficerët dhe ushtarët për veprime me eksplozivë, duke evidentuar rrezikun për personelin në operacion, komunitetin dhe pronën.

Objektivi i këtij kursi është aftësimi i kursantëve për identifikimin dhe asgjësimin në vend të municioneve të paplasura në operacion si dhe marrjen e njohurive për dhënien e ndihmës së parë në rast incidenti.

Ky program është sfidues për kursantët, pasi përmban teknika me nivel të lartë teorik e praktik sipas e standardeve



të NATO-s, të cilat duhen përvetësuar si në teori ashtu dhe veprime praktike, prandaj kërkon përkushtim maksimal si nga instruktorët ashtu dhe nga

kursantët. Në ceremoninë e fillimit të kursit morën pjesë përfaqësues nga Komanda Tokësore, shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Arben



Dhuli, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zylaj si dhe komandantë repartesh. Ceremoninë e hapi komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel

Ylli Zylaj, i cili u uroi mirëseardhjen kursantëve të rinj dhe i siguroi ata për mbështetjen që do të kenë në përfundimin me sukses të këtij kursi.

Një grup ekspertësh amerikanë viziton Komandën Mbështetëse

Komandën Mbështetëse e vizitoi një grup ekspertësh amerikanë të kryesuar nga z. Sam Jones, i përbërë me specialist të fushës së logjistikës, mirëmbajtjes së teknikës luftarake dhe marrëdhënieve strategjike.

Ekipi u prit nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebeuxhia. Gjatë takimit u diskutua rëndësia që ka mbështetja logjistike në menaxhimin e situatave të ndryshme operacionale si dhe situata aktuale e mbështetjes logjistike të trupave, mirëmbajtjen dhe riparimin e teknikës luftarake si dhe ecurinë e ndërtimit të infrastrukturës ushtarake.

Pas këtij takimi nga shefi i Shtabit të KM, kolonel Arben Dhuli u vazhdua me një prezantim mbi misionin e Komandës Mbështetëse, detyrat, organizimi, mbështetja që sigurohet nga kjo strukturë si dhe sfidat e furnizimit për FARSH.

Me tej, ekipi, sipas axhendës shkoi në Qendrën e Riparim Mirëmbajtjes së Teknikës të FA-së, ku u njoh nga afër me punën në këtë qendër si dhe me kërkesat e tyre për bashkëpunim në fushën e trajnimit të personelit



për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve/mjeteve të ardhura nga USA.

Ekipi shoqërohej nga specialistë

shqiptarë të kryesuar nga drejtori i Drejtorisë Logjistike, kolonel Alaksandër Pando.

Batalioni i Tretë i Këmbësoresë, përfundoi stërvitjen dimërore "Tomori-23", duke testuar me sukses aftësitë profesionale të efektivëve të tij në terrenin e vështirë malor dhe me dëborë, të malit të Tomorit.



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Si gra, ende nuk kemi arritur çdo gjë në mbrojtjen e të drejtave tona

"8 Marsi është mbi të gjitha arritje e të pamundurës"

Për ju koleget e mia që shërbeni në Forcat e Armatosura!

Në këtë ditë të shënuar, dëshiroj t'ju drejtohem juve, jo vetëm si zëvendëssefe e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e si gjenerale, por si njëra prej jush, si grua, kolege, nënë e motra juaj:

"Gëzuar festën e 8 Marsit, Ditën Ndërkombëtare të Gruas, shëndet e lumturi paçi në çdo aspekt të jetës tuaj familjare e shoqërore!"

Që nga nëntori i vitit 1977, Kombet e Bashkuara (UN), 8 marsin e kanë njohur botërisht si "Ditën e Gruas", ditë kur të drejtat e gruas u vunë në agjendën e ditës të politikës mbarëkombëtare, për shkak se, që më 8 mars 1857, gratë punëtore të një fabrike tekstili dhe veshjeje të Nju Jorkut - SHBA u ngritën kundër shtypjes dhe shfrytëzimit në punë, për të fituar të drejtat e tyre dhe të shumë ngjarjeve të tjera të mëvonshme.

8 marsi është një ditë e shënuar edhe për gratë shqiptare, të cilat nga dita në ditë e gjejnë veten e tyre më të vlerësuar e më të ndërgjegjshme për rolin e tyre në jetë e shoqëri. Në këtë kuadër edhe gratë ushtarake, ky 8 mars i gjen më optimiste për të ardhmen e tyre.

Në mënyrë të veçantë dëshiroj të përshëndes femrat ushtarake që ky 8 mars i gjen në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së, që nga Sudani i Jugut, Bullgaria, Kosova, por edhe në shtabet e NATO-s e Përfaqësitë Ushtarake e ambasadat shqiptare jashtë vendit.

Gjithashtu, një urim special kam për të gjitha ato gra e vajza ushtarake, kryesisht mjekë dhe infermiere të mjekësisë ushtarake, por edhe të strukturave të tjera të FT e KM, që morën pjesë në operacionin për shpëtimin e jetëve njerëzore, për shkak të tërmetit të 6 shkurtit të këtij viti në Turqi. Ato meritojnë vlerësim e mirënjohje nga të gjithë, pasi u treguan të gatshme, pa marrë parasysh asnjë pengesë e vështirësi për të qenë së bashku me shokët në operacionin humanitar.

Ky 8 mars, një pjesë të femrave ushtarake shqiptare i gjen në fushat e poligonet e stërvitjes, në mbështetjen e furnizimit e reparteve, i gjen pranë anijeve luftarake e pranë mjeteve ajrore, i gjen në patrullim në detyrat policore, në kryerjen e shërbimit të rojës, në auditorët e Akademisë së Forcave të Armatosura, në kurse të ndryshme të arsimitit e të kualifikimit pranë Kolegjit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, në ndjekjen e situatës në Ukrainë me dëshirën dhe shpresën



për ndërprerje sa më parë të luftës, e cila u ka marrë jetën shumë civilëve të pafajshëm, midis tyre edhe gra e fëmijë; i gjen në Shtabin e Përgjithshëm e në shtabet e Komandave të Forcave, në strukturat e Ministrinë e Mbrojtjes, e kudo tjetër ku është nevoja dhe ku e kërkon funksioni organik, duke mos neglizhuar për asnjë çast e moment nga kryerja e detyrave, të cilat gjej rastin t'i përshëndes e t'i falënderoj për përkushtimin e treguar ndaj detyrës.

Në këtë 8 mars gjej rastin të falënderoj ministrin e Mbrojtjes z.

Niko Peleshi dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingjin, për kujdesin e mbështetjen e treguar ndaj femrave ushtarake, si në rekrutimin, promovimin dhe ecurinë e tyre në detyrë e karrierë, e cila ka bërë që sot numri i femrave ushtarake të jetë 15.01%, me objektivin për të qenë në rritje.

Pikërisht në saje të kësaj mbështetjeje të lidërshipt ushtarak e civil, ku nuk i gjen sot femrat ushtarake.

Ato i gjen, jo vetëm nëntogere,

togere, kapitene e majore, por edhe me grada të larta e madhore si nënkolonele, kolonele e deri gjenerale, i gjen komandante strukturash të ndryshme ushtarake, pedagoge, me grada shkencore, drejtore drejtorish, atashe ushtarake, si edhe piloten e parë femër etj.

Ashtu sikurse femrat ushtarake aktive edhe ato në rezervë i gjen sot deputete, biznesmene, por edhe shtëpiake të papuna. 8 marsi është festë për të gjitha, prandaj në këtë ditë të shënuar një urim të veçantë dëshiroj t'iu jap gjithë atyre ushtarakeve fem-

ra, ushtarë profesioniste, nënoficere e oficerë, të cilat për arsye ligjore e kanë ndërprerë karrierën ushtarake ose që për arsye moshe kanë dalë në pension "Gëzuar festën e Nënës", vlerësim e mirënjohje për kontributin tuaj në vite, si pjesë e Forcave të Armatosura! Krenare që i keni shërbyer me përkushtim e devotshmëri atdheut, duke sakrifikuar jo në pak raste veten dhe familjen Tuaj! Qofshi përjetë të lumtura, si nëna dhe si gjyshe!

Megjithëse trajtimi dhe vlerësimi që u bëhet sot femrave, ka njohur gjithmonë përmirësim e rritje si në aspektin ligjor, ashtu edhe në zbatimin praktik, përsëri ka vend që si gra të mos reshtim së kërkuari ndaj strukturave shtetërore, por edhe në familje ndaj bashkëshortëve tanë një trajtim dinjitoz e të barabartë. Prandaj në këtë 8 Mars, datë të cilën nuk duhet ta konsiderojmë vetëm si ditë feste, por edhe si ditë të manifestimit të kërkesave tona, iu bëj thirrje grave ushtarake e patjetër edhe atyre civile:

"Luftoni e kontribuoni më shumë për veten tuaj! Mos pushoni së studiuar për të arritur me punë e mundim çdo ambicie profesionale e të karrierës edhe atë që konsiderohet e paarritshme! Luftoni dhe kërkoni të gjejnë zbatim të gjitha ligjet në fuqi që u japin të drejta grave ashtu si edhe burrave! Luftoni e kërkoni që promovimi në detyrë e gradë të mos konsiderohet si "lëmoshë e mëshirë" ndaj femrave, por si një e drejtë që ju takon dhe e meritoni! Luftoni dhe kërkoni që edhe në familje të mos jeni pre e dhunës dhe e diskriminimit, siç ndodh në ndonjë rast edhe ndaj femrave ushtarake! Kurrë mos pranoni dështimin në karrierën tuaj! Edhe nëse ndodh përpiguni për të bërë të pamundurën. Dështimi juaj duhet të jetë sfidë për të tjerat!"

Ambiciet tona si individë, në pozicionin e punës, por edhe në grup si gra duhet të jenë të arrijmë gjithçka që është e mundur, gjithmonë të tregojmë me aftësi e me punë se jemi në gjendje të bëjmë punë të dobishme ndaj shoqërisë dhe atdheut, aq sa edhe burrat. Por kur këto t'i kemi arritur, të dimë t'i vëmë në zbatim e të mos zhgënjëjmë në besimin e dhënë ndaj nesh. Mos mendoni asnjëherë se si gra kemi arritur çdo gjë në mbrojtjen e të drejtave tona. 8 marsi është mbi të gjitha arritje e të pamundurës.

Gëzuar festën e Nënës!



Deri më tani, poeti Lasgush Poradeci është ai, i cili ka përshkruar dhe botuar i pari historinë e krijimit të himnit tonë. Në punimin “Himni kombëtar i Flamurit, pranë të bashkuar dhe gjeneza e tij”, L. Poradeci bëhet kështu edhe rrëfyesi kryesor për këtë ngjarje madhore. Në rrëfimin e tij të tërheq vëmendjen një hollësi. Kjo hollësi, lidhet me faktin e thjeshtë se askush në ato çaste historike për Shqipërinë, nuk mendonte se ajo këngë e ngritur dhe e kënduar për të parën herë nga kori i kolonisë shqiptare të Bukureshtit, do të ishte himni i ardhshëm. Ja ç’ thotë Lasgushi: “Me fjalë të tjera, himni nuk u përgatit me qëllimin e posaçëm që të shërbejë si Himn Kombëtar, të përmbushë misionin e shenjtë të këngës simbolike zyrtare të popullit”. Nga këto radhë, por dhe nga zhvillimi i mëtejshëm i historisë së Shqipërisë, vëmë re se në kushtet kur nuk kishte shtet shqiptar ishte jashtë mendjeje, që dikush të mendonte që në fillim të kishim himnin e pastaj të bënim shtetin, si me thënë “buxhakun para oxhakut”. Shumë vite më vonë, poeti i shquar Migjeni shkroi poezinë me titull “Kënga që s’ kuptohet”, kushtuar melodisë sonë kombëtare. Në përpjekje për ta zhvendosur titullin e poezisë nga konteksti i saj, do të shohim se ky emërtim qëndron fare mirë për të, nisur jo vetëm nga largësia nga data e krijimit të himnit, por edhe se shkrimet historike për gjenezën e himnit tonë, kanë shërbyer në të njëjtën kohë edhe si kronikë besnike e lindjes së tij, por edhe si alibi.

Himni “Rreth flamurit të përbashkuar” është pranuar si himn kombëtar i Shqipërisë në vitin 1912. Fjalët e himnit janë shkruar nga Asdreni, muzika e himnit është kompozuar nga Ciprian Porumbesku.

Duke i shqyrtuar një nga një për sa më sipër, e vërteta do që të theksohet fakti kuptimplotë, se përpara se himni të bëhej himn zyrtar i shtetit të ri shqiptar, më 1912, po sipas Lasgushit, “kjo ngjau se populli e gjeti të pëlqyer; vetë e dëshiroi ai ashtu, nga gjiri i tij i dha trajtën dhe frymën, vetë e shenjtëroi, duke e dashur me zemër gjer në therori dhe më shumë e përtej vetëtherorisë. Me të luftuan çetat e kryengritjes që ishin nëpër gjithë viset e Atdheut, dhe vdiqën vdekjen e ëmbël dëshmorët e lirisë. Me të u ngrit Flamuri në Vlorë”. Me pak fjalë, kjo do të thotë që ngritja e flamurit nën tingujt dhe fjalët e “Betimit mi flamur” ishte vetëm një akt formal nga ana e Ismail Qemalit, për

ta njohur këtë këngë si këngën tonë kombëtare.

Së dyti, lidhur me fjalët e himnit, në asnjë vend të botës, nuk gjejmë një himn kombëtar, i cili t’i kushtohet po një simboli tjetër kombëtar siç është flamuri dhe që të dy së bashku t’i kushtohen atdheut.


Problemi i shqyrtimit të historisë së krijimit të himnit tonë kombëtar “Himni i Flamurit”, shpreh lidhjen me njërin prej simboleve tona kombëtare.

Në një vështrim të përgjithshëm, çështja e himneve kombëtare të vendeve të ndryshme është një problem i cili filloi të popullarizohej fillimisht në Angli, diku aty nga mesi i shek. XVIII. Në fakt, himne ka pasur edhe përpara kësaj kohe, por rëndësia dhe kuptimi i tyre nuk ka qenë në këtë shkallë kaq të rëndësishme të cilës i referohemi neve sot, pasi askush nuk e mendonte se ky lloj formimi i ri muzikor do të përfaqësojë një nga gjetjet gjeniale të të shprehurit të shpirtit të popujve. Muzikologjia daton si të parin himn atë të Holandës, himn i cili i përket vitit 1572 - “Wilhelmus van Nassouwe”. Ndërkohë, himni me fjalët më të vjetra në origjinë i përket himnit japonez, rreth shek. IX, tekst i cili rrjedh kryesisht nga folklori. Po në këtë arsyetim,

**Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshir' e një qëllim,
Të gjith' atij duke iu betuar
Të lidhim besën për shpëtim.**

**Prej lufte veç ai largohet
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk friksohet,
Po vdes, po vdes si një Dëshmor!**

Himni kombëtar, identiteti që përfaqëson çdo popull



Poezia e plotë

“Betimi mi flamur”, e shkruar dhe publikuar nga Asdreni në vitin 1908

**Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshir' e një qëllim,
Të gjith' atij duk` ju betuar
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ay largohet
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk frikohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor!
Në dorë armët do t' i mbajmë
Të mprojmë atdhenë me çdo kënt,
Të drejtat tona ne s' i ndajmë;
Këtu armiqet s' kanë vent.
Se Zoti vetë e tha me gojë
Që kombe shuhen përm'i dhe,
Po Shqipëria do të rrojë;
Për të, për të luftojmë ne!
O flamur, flamur, shenj` e shenjtë,
Te ty betohemi këtu,
Për Shqipërin` atdhen` e shtrenjtë,
Për nder` edhe lavdimn` e tu.
Trim, burrë quhet dhe nderohet
Atdheut kush iu bë theror;
Për jet` ay do të kujtohet
Mi dhe, mi dhe si një shenjtor!**

himni më i gjatë në ekzekutim është “Marcha de la Patria”, i Argjentinës kompozuar nga Blas Parera në vitin 1813; ndërkaq himni kombëtar me më shumë vargje është ai i Greqisë etj. Pra siç e shohim, historia e formimit të himneve kombëtare është e ndryshme në vende të ndryshme. Me sa duket, në përcaktimin ose jo të një krijimi muziko-letrar si himn kombëtar, rol kryesor kanë luajtur edhe kontekste të caktuara, kryesisht historike në historinë e një vendi. Por ka edhe shembuj të tjerë. Këtu gjejmë rastin të përmend faktin, se p.sh. himni zyrtar i Vatikanit u përcaktua në vitin 1949 me anë të një vendimi zyrtar të Selisë. Në bazë të himnit të Vatikanit qëndron muzika e kompozitorit francez Charl Guno, i cili e shkroi këtë muzikë në vitin 1846 (vepra quhet “Marcia Pontificiale” dedikuar papa Piut të XI), muzikë e cila gati 100 vjet më vonë u vendos të ishte himn zyrtar i Selisë së Shenjtë. Dhe raste të tilla ka shumë.

“Himni i Flamurit” ose titulli i gabuar “Rreth Flamurit të Përbashkuar” me të cilin njihet më shpesh, është përdorur për herë të parë në 1912, me shpallen e Pavarësisë së Shqipërisë.

Fillimisht himni ishte një marsh rumun i përdorur edhe si himn kombëtar. Kënga u kompozua nga Ciprian Porumbescu ndërsa autor i tekstit është rilindasi Asdreni.

STOCKHOLM, SUEDI, TAKIMI I MINISTRAVE TË MBROJTJES TË BE-SË

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

NATO do të rimbushë rezervat e municioneve dhe do të rrisë prodhimin

Gjatë mbërritjes në takimin e ministrave të Mbrojtjes të BE-së, të mërkurën (8 mars 2023), Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg nënvizoi rëndësinë e forcimit të rezervave të municioneve dhe të më shumë prokurimeve të përbashkëta në mënyrë që të vazhdohet mbështetja për Ukrainën. Ai vuri në dukje se aleatët e NATO-s i kanë ofruar Ukrainës mbështetje me vlerë rreth 150 miliardë euro gjatë vitit të kaluar, nga të cilat 65 miliardë euro kanë qenë mbështetje ushtarake. Ai tha se bashkëpunimi NATO-BE vazhdon të jetë jetik në mbështetjen e Ukrainës dhe mbrojtjen e vlerave të përbashkëta.

Sekretari i Përgjithshëm ishte në një vizitë dyditore në Stokholm të Suedisë, në 7 dhe 8 mars 2023. Pas takimit me kryeministrin suedez Ulf Kristersson, ai u tha gazetarëve në një konferencë shtypi se pranimi i të dy vendeve, Finlandës dhe Suedisë në NATO, është një përparësi kryesore dhe se për këtë po bëhet përparim.

Më shumë mbështetje për Ukrainën, Rusia nuk duhet nënvlerësuar

“Ky takim vjen në një moment kritik për sigurinë tonë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, në deklaratën e tij përpara takimit të Këshillit të Punëve të Jashtme të Bashkimit Evropian me ministrat e Mbrojtjes. “Lufta e agresionit të Rusisë vazhdon të zhvillohet kundër Ukrainës dhe gjatë javëve dhe muajve të fundit, kemi parë luftime të ashpra brenda dhe rreth Bakhmutit, por ajo që po shohim tashmë është se Rusia po sulmon me më shumë trupa dhe me shumë forca dhe ajo që asaj i mungon në cilësi, ata po përipiqen të plotësojnë në sasi. Rusia ka pësuar humbje të mëdha, por në të njëjtën kohë, nuk mund të përjashtojmë që Bakhmut të bjerë përfundimisht në ditët në vijim”, - tha Sekretari i Përgjithshëm, teksa foli mbi betejën e ashpër në Bakhmut. “Por është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se megjithatë kjo nuk pasqyron domosdoshmërisht ndonjë pikë kthese të luftës, por thjesht thekson se ne nuk duhet të nënvlerësojmë Rusinë. Ne duhet të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje për Ukrainën”. Aleatët e NATO-s e kanë mbështetur gjatë vitit të kaluar Ukrainën me mbështetje ushtarake, financiare dhe ekonomike me vlerë rreth 150 miliardë euro, nga të cilat 65 miliardë euro janë mbështetje ushtarake. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të rritur prodhimin e municioneve, çështje që aleatët e NATO-s e kanë trajtuar prej disa kohësh. “Do të biem dakord për udhëzime të reja, kërkesa të reja për rezervat e municioneve, duke siguruar që ne së bashku mund të plotësojmë rezervat tona, por gjithashtu të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje për Ukrainën”. Aleatët e NATO-s kanë nënshkruar kontrata me industrinë e mbrojtjes për të rritur prodhimin, duke pasur parasysh sinjalet afatgjatë të kërkesës dhe disa aleatë të NATO-s gjithashtu kanë hyrë në projekte të përbashkëta ose prokurime të llojeve të ndryshme municionesh, por edhe për magazinimin e municioneve. “Takimi i ministrave të Mbrojtjes të BE-së e diskutoi këtë çështje, si një ndër çështjet më me rëndësi, si dhe të gjitha sfidat me të cilat përballemi së bashku. Por mbi të gjitha ajo që kemi parë gjatë gjithë luftës në Ukrainë është se si NATO dhe Bashkimi Evropian qëndrojnë së bashku, plotësojnë njëri-tjetrin dhe punojnë së bashku për të mbrojtur vlerat tona”.

Prodhimi i municioneve dhe rritja e rezervave të NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-



s, ka paralajmëruar vazhdimisht se mbështetja e Aleancës për Ukrainën kërkon rritjen e kapaciteteve prodhuese për prodhimin e armëve dhe municioneve në mënyrë që të dërgohet më shumë municion në fushën e betejës. Pasi kjo tani është një luftë rrëtimi, është një betejë logjistike theksoi ai. “Ne kemi reduktuar rezervat tona të municionit për t’i dhënë Ukrainës, por nga ana tjetër përdorimi i municioneve në Ukrainë është më i lartë se prodhimi i tyre dhe kjo nuk është një situatë e qëndrueshme në një perspektivë afatgjatë. Bëhet fjalë për marrjen e furnizimeve, municioneve, karburantit në vijën e frontit të ushtarët. Kjo ishte e qartë gjatë gjithë vjeshtës së kaluar dhe kjo është arsyeja pse NATO rriti përpjekjet e saj për të punuar me industrinë dhe për të rritur prodhimin, si dhe pse ne filluam punën për zhvillimin e kërkesave të reja për rezervat, si pjesë e atij procesi të planifikimit të mbrojtjes së NATO-s, objektivat tona të aftësisë”, - tha Stoltenberg. Aleatët e NATO-s tashmë kanë nënshkruar kontrata, të cilat kanë mundësuar rritjen e prodhimit. Ka masa të mëtejshme nga BE-ja, të cilat do të forcojnë procesin për të marrë më shumë municion dhe vendet hyjnë në të ashtuquajturën procedurë të përbashkët të prokurimit. Kjo është një praktikë të cilën NATO e ka bërë për shumë vite dhe do të vazhdojë gjithashtu ta bëjë. “Kjo është e mirë, kjo është diçka që unë e mirëpres, pasi ka një kërkesë të madhe atje. Shkalla aktuale e konsumit në krahë me shkallën aktuale të prodhimit të municioneve nuk është e qëndrueshme prandaj ne duhet të rrisim prodhimin. Unë e mirëpres që BE-ja po rrit prodhimin dhe aleatët e NATO-s gjithashtu”. Ndërkohë, mes aleatëve të NATO-s tashmë ka projekte të përbashkëta për të siguruar sa më shumë municion për artilerinë, më shumë municione për sistemet e mbrojtjes ajrore, gjithashtu ka dhe infrastrukturë më të mirë, si dhe depo për municionet. “Pra, kjo është diçka për të cilën po punojmë. Ne kemi parë hapa të rëndësishëm tashmë të ndërmarrë, por duhet të bëjmë më shumë,

sepse ne duhet të sigurojmë që Ukraina të marrë municionet që i nevojiten për t’u mbrojtur kundër agresionit të luftës të Rusisë. Ne duhet të rimbushim rezervat tona sepse deri më tani, mbështetja jonë për Ukrainën ka ardhur kryesisht nga varfërimi i rezervave të NATO-s. Sigurisht, në planin afatgjatë, kjo nuk është e qëndrueshme. Kjo është dhe arsyeja pse NATO filloi të punojë për rritjen e prodhimit”.

Sulmi mbi “Nord Stream” nuk erdhi nga Ukraina, mbrojtja e infrastrukturës kritike

Sipas disa mediave gjurmët e atentatit ndaj tubacionit “Nord Stream 2” të ndodhur vitin e kaluar, të çojnë tek një grup pro ukrainas, i cili mund të ketë sulmuar gazsjellësin. Por Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s nuk e konfirmoi këtë raport. Jens Stoltenberg tha se “ajo që ne dimë është se ka pasur një sulm kundër tubacioneve “Nord Stream”, një akt sabotimi, por ne nuk kemi qenë në gjendje të përcaktojmë se kush ishte pas sulmit”, - tha ai. “Ende ka hetime kombëtare në vazhdim, por nuk duhen bërë spekulime dhe është e drejtë të presim derisa ato hetime të finalizohen përpara se të themi diçka më shumë se kush ishte pas sulmit. Por nga ana tjetër ajo që dimë dhe që mund të themi me siguri është se këto sulme tregojnë cenueshmërinë e infrastrukturës thelbësore gjithashtu është se kjo tregon rëndësinë e mbrojtjes së infrastrukturës sonë kritike nënujore, sepse ne kemi mijëra kilometra tubacione gazi, tubacione naftë, rrjete energjetike dhe gjithashtu, natyrisht, të gjitha kabllot e internetit. E gjithë kjo infrastrukturë është kritike për shoqëritë tona”. Megjithatë NATO e ka trajtuar këtë për shumë vite më parë dhe pas sulmeve kundër tubacioneve “Nord Stream”, ajo ka rritur mbrojtjen. “Ne kemi krijuar një njësi të veçantë për të bashkërenduar masat në selinë e NATO-s, për të koordinuar përpjekjet midis aleatëve tanë të NATO-s, për të ndarë më shumë informacion ndërmjet shteteve anëtare dhe industrisë private, që shpesh zotëron këtë

infrastrukturë dhe për të bërë më shumë për të minimizuar rrezikun dhe për të rritur mbrojtjen e infrastrukturës kritike nënujore”, - tha ai. Aleanca për shumë vite ka pasur në vëmendje sigurinë e infrastrukturës së saj, por pas sulmeve në Detin Baltik, ajo ka dyfishuar praninë e saj ushtarake si në Detin e Veriut edhe në Detin Baltik. “Ne kemi rritur gjithashtu bashkëpunimin midis vendeve të NATO-s për të shkëmbyer informacion dhe për të forcuar gatishmërinë për të ndaluar më mirë sulme të tilla në të ardhmen”.

Koha për të mirëpritur Finlandën dhe Suedinë si aleatë të NATO-s

Ka ardhur koha për të mirëpritur Suedinë dhe Finlandën në NATO, tha Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg edhe në fillim të vizitës dyditore në Stokholm, të martën e 7 marsit 2023. Ai u tha gazetarëve në konferencën e përbashkët të shtypit, pas takimit me kryeministrin suedez Ulf Kristersson, se “pranimi i të dy vendeve është një përparësi kryesore dhe ne po bëjmë përparim”, duke vënë theksin edhe në takimin midis Turqisë, Suedisë dhe Finlandës në selinë e NATO-s, më 9 mars. Ai gjithashtu përshëndeti që Parlamenti hungarez ka filluar diskutimet për ratifikimin, duke pritur që procesi atje të përfundojë së shpejti. “Anëtarësimi i Suedisë dhe Finlandës do ta bëjë Aleancën tonë më të fortë, - tha Sekretari i Përgjithshëm, - me forca shumë të afta, një industri të avancuar të mbrojtjes dhe vite përvojë trajnimi dhe operimi së bashku me aleatët”. Ai shtoi se aplikimet e Suedisë dhe Finlandës tashmë e kanë forcuar sigurinë e tyre dhe se është e paimagjinueshme që NATO të mos vepronte nëse kjo siguri kërcënohej. Duke paralajmëruar se presidenti Putin po përgatitej për sulme të reja kundër Ukrainës, Stoltenberg tha se ka një nevojë urgjente për të rritur mbështetjen për Ukrainën. “Lufta e Presidentit Putin kundër Ukrainës vazhdon. Ai nuk po përgatitet për paqe, ai po përgatitet për më shumë luftë. Këtë e tregon nisja e ofensivave të reja, mobilizimi i më shumë forcave, si dhe Rusia po i drejtohet regjimeve të tjera autoritare me kërkesa për më shumë armë. Kështu që sot diskutuam nevojën urgjente për të rritur dhe mbështetjen tonë për Ukrainën, për hir të Ukrainës dhe gjithashtu për sigurinë tonë”, - tha Stoltenberg. Ai tha se mirëpret ndihmën e konsiderueshme financiare, humanitare dhe ushtarake që Suedia po i ofron Ukrainës. Kjo ndihmë përfshin stërvitje, municion artilerie dhe së shpejti, tanke kryesore të betejës. “Suedia po luan gjithashtu një rol udhëheqës përmes Presidencës suaj në Bashkimin Evropian. Koordinimi i më shumë mbështetjes për Ukrainën dhe më shumë sanksione ndaj Rusisë. Më shumë se një vit që nga pushtimi i plotë i Rusisë, Ukraina qëndron sfiduese”.

“NATO është e bashkuar dhe Aleanca e saj është më e fortë se kurrë dhe së shpejti do të jetë më e madhe, pasi finalizimi i pranimit të Suedisë dhe Finlandës në NATO, është një prioritet kryesor dhe ne po bëjmë përparim. Turqia nga ana e saj ka shqetësime legjitime për sigurinë dhe ndërkohë asnjë aleat i NATO-s nuk ka pësuar aq shumë sulme terroriste. E mirëpres që Suedia ka rritur luftën kundër terrorizmit, duke përfshirë PKK-në, duke futur legjislacio-

nin e ri për terrorizmin dhe duke forcuar bashkëpunimin kundër terrorizmit me Ankarën. Unë mirëpres gjithashtu që Suedia po siguron që nuk ka kufizime në eksportet e armëve në Turqi. Suedia ka përbashkëpunuar angazhimet e saj sipas Memorandumit Trepalësh, prandaj ka ardhur koha për të finalizuar procesin e ratifikimit. Së fundmi jam takuar me Presidentin Erdogan dhe më vjen mirë që ai ra dakord për rifillimin e takimeve të Mekanizmit të Përbashkët të Përhershëm”, - tha Stoltenberg dhe përshëndeti gjithashtu që Parlamenti hungarez ka filluar diskutimet për ratifikimin. “Pres që procesi të përfundojë së shpejti. Anëtarësimi i Suedisë dhe Finlandës do ta bëjë Aleancën tonë më të fortë, me forca shumë të afta, një industri e avancuar e mbrojtjes dhe vite përvojë trajnimi dhe operimi së bashku me aleatët e NATO-s. Aplikimet e Suedisë dhe Finlandës kanë forcuar tashmë sigurinë tuaj. Ju jeni ulur rreth tryezës së NATO-s, duke u integruar në strukturat tona politike dhe ushtarake, duke ushtruar më shumë me forcat aleate”. Ndërkohë që NATO ka rritur praninë e saj në rajonin Nordik, shumë aleatë kanë dhënë garanci sigurie për Suedinë dhe Finlandën. “Pra, është e paimagjinueshme që NATO të mos vepronte nëse do të kërcënohej siguria juaj. Ftesa juaj për anëtarësim në Aleancë ka treguar edhe një herë se dera jonë mbetet e hapur. Presidenti Putin donte më pak NATO. Ai po merr krejt të kundërtën, më shumë NATO”, - tha shefi i NATO-s.

Kujtojmë se të gjithë aleatët e NATO-s, gjithashtu edhe Turqia, morën një vendim historik në Samitin e NATO-s, qershorin e kaluar dhe të gjithë ranë dakord të ftonin Finlandën dhe Suedinë për t’u bërë aleatë të NATO-s. Që atëherë, Aleanca ka integruar Finlandën dhe Suedinë në strukturat civile dhe ushtarake të NATO-s. Suedia dhe Finlanda kanë një status krejtësisht të ndryshëm, duke qenë tani gjithnjë e më shumë pranë NATO-s. Disa aleatë të NATO-s dhanë gjithashtu garanci sigurie për Finlandën dhe Suedinë. “NATO ka rritur praninë e saj në këtë rajon, gjë që do të thotë se ajo do të reagojë (do të aktivizojë nenin 5), nëse do të ketë një kërcënim ushtarak kundër Finlandës dhe Suedisë. Pra, Finlanda dhe Suedia janë në një pozitë shumë më të sigurt, shumë më të mirë tani sesa përpara se të aplikonin. Kjo është e mirë për Finlandën dhe Suedinë, por është gjithashtu e mirë për NATO-n”.

Kujtojmë gjithashtu se Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg u takua me Presidentin Erdogan disa javë më parë në Turqi në një takim pas tërmetit. “Unë isha atje për të shprehur ngushëllimet e mia pas tërmetit, por edhe për të diskutuar se si NATO mund të sigurojë mbështetje për Turqinë pas tërmetit. Ne diskutuam gjithashtu rrugën përpara për anëtarësim dhe po bëjmë përparim”. Presidenti Erdogan ra dakord që të rifillojë bisedimet dhe të ketë një takim me Finlandën, Suedinë dhe Turqinë në selinë e NATO-s, më 9 mars. “Kjo në vetvete është një gjë e rëndësishme pas një periudhe të gjatë pa bisedime. Ky është një proces që Finlanda dhe Suedia të bëhen aleatë e NATO-s. Ky është një prioritet kryesor. Ne do të vazhdojmë të integrojmë Finlandën Suedinë në Aleancën tonë”.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Pse linda femër?! Sikur të isha djalë?! Ah!! Shpesh në dilemë me veten, përballë realitetit, i cili na vë në provë me të paimagjinueshmen.

Të lindësh grua do të thotë të mbash mbi veten një mëkat të madh?!

Gruaja objekti apo subjekti i një makthi të vazhdueshëm ekzistence?

Në fakt që prej zanafillës së botës, Eva e mbart mëkatën mbi veten për dëbimin e njeriut nga Parajsa. Dhe vetëm me figurën e Shën Mërisë kjo qenie u hirësua.

Gruaja, kjo qenie e brishtë, hyjnia e bukurisë në këtë gen duhet të jetë njeriu që përballë gjithëherë me tragjiken.

Historia e patriarkalizmit të dhunshëm e agresiv, të cilit i përkasim, gjithmonë femrën e ka pasur kultin e mundimeve, të punës dhe të flijimeve.

Shprehje të tilla si: “vajza është derë e huaj”, “djali i saj është i huaj, nuk trashëgon si djali i djalit mbiemrin e trungut familjar të nënës”, “vajza sjell një armik që fle tok në shtëpi (dhëndrin) e shyqyr zotit që e martuam”, etj., janë shprehje të hapura të një racizmi të trashëguar nga patriarkaliteti që himnizon mashkullin.

Qenia e saj e mbyt familjen që në lindjen e vet. Një karakteristikë që shpreh psikologjinë e pritjes së një fëmije të sapolindur është zakoni i të shkrepurit të pushkës me lindjen e djalit dhe heshtja totale me lindjen e vajzës, në të kaluarën e ndofta edhe sot në një pjesë të madhe të shqiptarëve.

Në kohën e Komunizmit, në Shqipëri shumë baballarë nuk i afroreshin maternitetit kur gruaja e vet lindte vajzë. Ndër kohëra të vjetra e deri më sot, për shqiptarin ndryshe përjetohet lindja e një djali për pushkë dhe ndryshe lindja e një vajze për punë.

Sa tragjike ardhja e një gruaje në jetë! “Mjerë ti o e shkrete, që linde femër!”, vajtonin nënat tona të sunduara nga pushteti i patriarkalitetit.

Shprehje të tilla si: “Gruaja është me shpatulla pas murit”; Mbyll gojën se është turp, je femër!”, nëse nuk tregojnë diskriminim social dhe dhunë psikologjike mbi femrën, çfarë tjetër tregojnë?

Të lindësh grua, ku një në tre femra dhunohen fizikisht dhe dy në tre psikologjikisht, është vërtetë tragjike. Të lindësh grua do të thotë të mos mundësh të jetosh pa çatinë e një mashkulli babës, vëllait, burrit.

Pa një çati të tillë gruaja është lënëshë, e padenjë, e pamoralshme, e fëlliqur, e mjerë, qyqare e ku di unë, gjithfarë epitetesh fyese, përulëse e keqardhëse, një klasë shoqërore në moshë të mesme ndër më të përçmuarat, më të përbuzurat nga shqiptari.

Pothuajse asnjë shqiptar akoma

“Gruaja doli nga brinja e burrit, jo nga këmbët për t’u shkelur, jo nga koka për të qenë superiore, por nga ana për të qenë të barabartë, nën krah për të qenë e mbrojtur, pranë zemrës për t’u dashur”



edhe sot në shek. XXI nuk mund të konceptojë një grua të vetme në shtëpi larg babait, vëllait e të afërmeve nëse është e pamartuar, ose nuk bashkëjeton me dikë.

Ashpërsia dhe vrazhdësia tragjike mbi femrën e konsoliduar prej shekujsh në ndërgjegjen shqiptare gjen mishërimin e vet në figura të grave që shndërrohen në burra, për të shpallur pavarësinë e tyre të fortë ndaj kësaj shoqërie, që edhe sot e kësaj dite kërkon të shndërrojë identitetin e saj të ëmbël në fortësi me fjalën “burrneshë” në Veri e “kapedane” në Jug.

Kultura e të qenit femër në Shqipëri është ajo e një dhune psikologjike.

Shpesh qëndrimet mohuese e ndëshkuese ndaj femrës arrijnë deri në hakmarrje. Sa krime për “motive të dobëta” realizohen në Shqipëri për tradhtinë bashkëshortore! Madje nga burra që kanë tradhtuar kush e di sa herë gruan e tyre. Pa analizuar aspak arsytet dhe pasojat, shqiptari kalon përherë në ekstrem me “krenarinë” mashkullore dhe “fëlliqësinë” femërore. Sa marrëdhënie të dyfishta e shpesh të shumëfishta?!

Pa dyshim koncepti i gruas si një qenie sublime, e cila duhet respektuar me brishtësinë e saj, me bukurinë dhe mirësinë e saj, pasi është pikërisht ajo që i jep kuptimin e forcës dhe lumturinë një mashkulli, është pikërisht terapia sociale.

Gruaja nuk mund të jetë kurrë fatkeqësi e domosdoshme e realitetit tragjik. Ajo, e bukura, e mira, lozonjarja, e duruara, e dhembshura është bekim për shoqërinë.

Prej saj nis jeta, prej saj nis edhe një shoqëri më e mirë ndër shqiptarë, sepse

është ajo që ka në duar të ardhmen e fëmijëve të vet, e këta të fundit të ardhmen e këtij vendi duke pasur nevojën jetike për mirëkuptim ndaj njëri-tjetrit.

Vajza, bija, gra, nëna, ju që në udhëtimin tuaj kaloni mes cikloneve por që fuqishëm ngriheni në këmbë dhe me krahët e fortë ‘të shqipes’ mbronin familjen, fëmijët pa marrë parasysh koston e asgjësë me emrin ‘jetë’.

Nënë, qenia më sublime, që me krahët e saj lëshon dashurinë si një breshër i fortë dhe bota ngjyroset në të gjitha skajet nga veriu në jug me nuanca e jetës. Ne jemi fryt i një nëne të palodhur, që çdo natë bie duke menduar dhe falënderuar Zotin, që i fali ndjenjën më të bukur që ekziston.

Nuk resht kurrë së ndaluar për të thyer çdo vuajtje që tronditin zemrën si një tërmet i fuqishëm në dashuri dhe ngrohtësi. Vetëm nënat e zotërojnë këtë aftësi sikur të kenë një damar të përbërë prej qelizash dashurie dhe jete.

Sikur ta rikthenim jetën pas si një film dhe të përfytyronim sesi do të ishte jeta pa nënën, a do ndiheshim të realizuar?

Kam frikë që jo, sepse edhe kur e shkruaj këtë frazë, me këtë penë të zezë ngjan sikur nuk jam një njeri, jam dikush që nuk ka ndjenja njerëzore, jam dikush që nuk është dikush në fakt, po thjesht një hije që kërkon të kthejë kohën e çmuar pas. Dashuria e gruas është gravitet, i bën njerëzit që të tërhiqen nga të tjerët. **Data 8 Mars, “Dita e Gruas”.**

Më 8 mars 1875, në ndërmarrjen e tekstit në Nju Jork gratë u ngritën në protestë kundër kushteve çnjerëzore të punës, orarit të gjatë dhe pagave të

ulëta. Dhe ia arritën qëllimit. Mos dyshoni njerëz tek forca e femrës?

Por, të jesh grua në Shqipëri, çfarë do të thotë?

Të jesh grua sot në Shqipëri është e vështirë. Në rrugëtimin drejt sakrificave të shumta që duhet të bëjë sot një grua, i duhet të durojë edhe peshën e madhe të paragjykitimit, diskriminimit, dhunës.

Hedh sytë në rrugë e shoh gra të mira, gra të cilat nuk janë veçse një shembull i mirë për familjen, si nëna e bashkëshorte të devotshme, por edhe për gjithë shoqërinë.

Me sytë e mendjes vizatoj një grua të zbrëthyer nga të gjitha paragjykimet, nga kornizat e kalbëzuara, një grua të lirë për të zgjedhur e për t’u zgjedhur.

Një grua protestuese... për një jetë më të mirë, për plotësimin e disa të drejtave më shumë, për të kërkuar barazi gjinore, për të bërë të mundur që askush të mos ngrejë dorë mbi to.

Hedh sërish shikimin këtë herë më ngultas, e shoh vështrime të trishtuara, është gruaja shqiptare, dhe në monologun e brendshëm pikëpyetjet e mia se: kur do të reshtin së qari këto krijesa, sa të brishta aq edhe të forta...? Kur do të reshtin së përdhosuri, keqtrajtuari, rrahuri...? Kur do të reshtin së vrari, nga dora e meshkujve të tyre, që përveçse i kanë besuar trupin, i kanë dhuruar edhe fëmijë...?

Askush përveç Zotit nuk mund të vendosë afate ekzistencash.

Burra, kuptojeni njëherë e mirë, drejta ta hajë, nuk jeni ju zotët e grave tuaja.

Gratë janë qeniet më të mrekullueshme, ato falin e dhurojnë dashuri pa limite, pa afate skadencash...

Ato prej kohësh kanë shërbyer si

muza frymëzimi...Të ëmblat dhe të kuptueshmet, besniket dhe të bukurat, ato që dashurojnë pafund, me gjithë qenien e tyre, këto janë gratë...

Jeta e tyre është gjithnjë si nëpër ato filmat, ku regjisori shkon larg e më larg me imagjinatën e tij.

Ja këto janë gratë, që mendojnë për çdo detaj, që kërkojnë shkaqe dhe pasoja.

E trajtojmë keq veten ne femrat, idealizojmë e më pas lëndohemi. Por përsëri dashurojmë më të gjithë fuqinë e shpirtit. Dashurojmë dhe kujdesemi deri në detaje për dashurinë tonë, duke e kërkuar shpesh fajin edhe tek vetja.

E shkreta grua!

Ajo ka rolin e saj në shoqëri, në familje, është një nënë shumë e mirë dhe një bashkëshorte e shkëlqyer ndaj përlligj gjithnjë, për të pretenduar sadopak lumturi. Për të qenë gjithnjë e adhurueshme për sytë e bashkëshortit të saj dhe fëmijëve. Për t’u dashur e për të dashur, sepse është e drejta e liria themelore e njeriut, është kauza e madhe që mban gjallë zemrat tona, që na bën të zgjohemi në mëngjes edhe kur nuk ekziston dëshira, që na bën të shkojmë para pasqyrës dhe t’i harrojmë rrathët e syve, që të rregullohemi e mbahemi se çdo ditë është e veçantë, për të qenë gjithnjë në qendër të vëmendjes, dhe jo për të pritur 8 Marsin për të bërë grim e për të veshur rrobat e reja që dergjen në gardërobën tonë.

Çdo ditë është e veçantë kur është e mbushur me dashuri. Mundohuni të shijoni çdo ditë në kalendarin tuaj, pa trysni negative, por me nuanca respekti. Ndaj dashuroni sa më shumë, për të përfutur grimca lumturie, çdo ditë e nga pak, çdo ditë e më shumë!

"Nëse do të mbjellësh për një vit, mbill misër dhe grurë, nëse do të mbjellësh përgjithmonë, mbill arsim dhe kulturë"

Mësonjëtorja e Korçës është shkolla e parë kombëtare e gjuhës shqipe në viset shqiptare në kohën e Perandorisë Osmane. Mësonjëtorja u hap, më 7 mars të vitit 1887, në Korçë, në periudhën e fundme të perandorisë. Tashmë ndërtesa e shkollës shërben si një muzeum dhe ndodhet në veri të bulevardit "Shën Gjergji".

Hapja e shkollës erdhi si rezultat i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që synonte të mundësoheshin të drejtat kombëtare brenda Perandorisë Osmane. Mësonjëtorja përbënte një qendër për edukimin kulturor dhe patriotik dhe kishte rëndësinë e një vlere të veçantë, duke qenë se shkrimi i shqipes nuk u lejua pas ngjarjeve të Lidhjes së Prizrenit.

Data e hapjes së saj festohet nga shqiptarët si "Dita e Mësuesit"

Në vitin 1885, Naim Frashëri, si zyrtar në Ministrinë e Arsimit në Stamboll, me të vëllain, Sami Frashërin dhe shqiptarë të tjerë me ndikim të "Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip", ia dolën të siguronin lejen nga Sulltan Abdylhamidi II për hapjen e një shkolle shqiptare për djem në Korçë. Mbështetja financiare iu mundësua edhe nga mërgata e Rumanisë, anëtarët e Shoqërisë "Drita", të Bukureshtit, ndërsa shqiptarët e Stambollit vendosën që drejtor i shkollës të ishte Pandeli Sotiri.

Mjedisi ku u vendos shkolla ishte shtëpia e dhuruar nga Diamant Terpo. Si "Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip", ashtu edhe shoqëria "Drita" kishin rënë dakord që më përpara për të mos antagonizuar parinë vendase të ndikuar nga kultura greke, duke hapur shkolla shqipe. Patrikana e Stambollit refuzoi që të jepej gjuha shqipe në shkollat ekzistuese greke të komunitetit ortodoks të Korçës. Pandeli Sotiri u dërgua në Korçë dhe e çeli shkollën më 7 mars 1887. Tekstet e shkollës i mundësonin vëllezërit Naim e Sami Frashëri dhe shumë shqiptarë të tjerë. Përgjatë 1887-ës, Pandeli Sotirit iu desh të linte Korçën dhe administrimi i shkollës i kaloi Petro Nini Luarasi dhe Thanas Sinës. Autoritetet osmane i dhanë leje vetëm të krishterëve shqiptarë të ndiqnin mësimin në këtë shkollë, por shqiptarët nuk iu bindën lejes dhe lejuan fëmijët myslimanë që të mund ta ndiqnin.

Vitet e para, në shkollë u regjistruan rreth 200 nxënës të besimit mysliman dhe të krishterë.

Në vitin 1888, shkolla kishte 100 nxënës të krishterë dhe 60 myslimanë. Pandeli Sotiri e filloi mësimin fillimisht me 35 nxënës. Hapja e kësaj shkolle për nga karakteri kishte tipare



demokratike, pasi në të mësonin fëmijët e të gjitha shtresave, të varfër e të pasur. Kjo shkollë kishte një klasë përgatitore si dhe katër klasa të rregullta.

Lëndët mësimore ishin shkrimi, këndimi, gramatika e gjuhës shqipe, historia, gjeografia, aritmetika, dituria natyrore dhe edukimi fizik.

Edhe pse në kushte të vështira, kur ndalohej rreptësisht mësimi i gjuhës shqipe për shkak të kushteve të ndodhura nën sundimin osman, Mësonjëtorja e Korçës qëndroi e hapur për 15 vjet, u mbyll në vitin 1902, për t'u rihapur në vitin 1908. U mbyll përsëri në vitin 1912 dhe u çel pas pesë vjetësh në 1917-ën. Përkrahës të saj ishin figura të njohura të Rilindjes shqiptare, si: Naum Naçi, Thoma Avrami, Familja Qiriazit etj.

Më 15 tetor 1891, Gjerashim Qiriazit së bashku me të motrën Sevasti Qiriazit hapën këtu edhe "Mësonjëtorën e vajzave", baza

e së cilës ishte gjithashtu gjuha shqipe dhe kultura kombëtare.

Kontributi i madh që këta atdhetarë dhe veprimtarë të shquar dhanë për kombin dëshmohet nga dëshira e zjarrtë që ata kishin për të përhapur dijen në popull. Me ato mundësi që kishin, ata u bënë iniciatorët e krijimit të teksteve të parashkollore të dokumentuara. Ata i përkushtuan një rëndësi të madhe pajisjes me mjetet e duhura të mësimdhënies, për të bërë më tej dhe shpërndarjen e tyre në nxënës. Të edukuar dhe me frymën e lartë të patriotizmit, këta nxënës do të bëheshin në të ardhmen dhe pasuesit e ideologjisë së mësuesve të tyre dhe luftëtarë të devotshëm për luftën për liri dhe pavarësi.

Në shenjë nderimi, respekti dhe kujtimi për kontributin e Mësonjëtores së Korçës dhe mësuesve të saj, 7 Marsi është caktuar si Ditë e Mësuesit dhe e shkollës shqipe.

Edhe përpara vitit 1887, padyshim që kishte institucione dhe qendra arsimore ku mësohej gjuha shqipe, mungonte tradita e një shkolle kombëtare shqiptare në kuptimin më të gjerë të fjalës. Mësimi i organizuar në Mësonjëtorën e Korçës kishte për bazë shkencën, kurse synimi i saj ishte dija. Ajo ishte shkollë shqiptare (sepse gjuhë mësimi ishte gjuha shqipe), shkollë popullore (sepse ishte dëshira e popullit për ta hapur dhe për ta mbajtur), në esencë demokratike (sepse ishte e hapur për të gjithë dhe pa pagesë), shkollë e përgjithshme laike (sepse aty vijonin mësimin fëmijët shqiptarë të të gjitha besimeve), shkollë e pavarur (sepse nuk finançohej nga jashtë, por mbahej nga populli) etj.

Hapja e shkollës ishte një ngjarje dhe një fitore e madhe për gjithë lëvizjen kombëtare.

Mësonjëtorja e Korçës ishte qendër e rëndësishme për formimin kulturor dhe ngritjen e ndërgjegjes dhe moralit në popull. Ajo nxiti edukimin patriotik të brezit të ri e të masave të gjera. Shkolla tërhoqi interesin dhe admirimin e shumë shqiptarëve. Nën shembullin e saj u frymëzuan më vonë edhe banorë të viseve dhe trevave të tjera shqiptare.

Veç të tjerash, kjo ngjarje ishte një fitore e madhe për popullin shqiptar, pasi deri atëherë dhënia e mësimave për shkak të pushtimit osman bëhej privatisht brenda shtëpive në mënyrë të fshehtë.



A duhet të kemi frikë nga AI?

Janë shumë prej nesh që kanë frikë se një ditë do të zëvendësohen nga një robot. Por a jemi vetë ne, raca njerëzore, që i krijuam ata?!

Deri në momentin që teknologjia u përdor për të na lehtësuar jetën në aspektin fizik, zhvillimi teknologjik konsiderohej arritja më e madhe e njerëzimit. Por, kur bëhet fjalë për zhvillimin e teknologjisë në aspektin e lehtësimit edhe të aktivitetit mendor përveç atij fizik, lind dyshimi dhe frika... Nëse ne nuk bëjmë aktivitet fizik sepse e bën kompjuteri për ne, dhe nëse ne nuk kemi pse të lodhemi as mendërisht, sepse e bën kompjuteri për ne, a nuk bën kjo që njeriu të kthehet në një qenie dembele, parazitare dhe si rrjedhojë të pësojë në një farë mënyre regres...?

Nëse njeriu e ushqen me të dhëna e informacione pafund AI-në, i jep pushet absolut, madje mbi vetë njeriun.

Nëse një njeri i vetëm, i konsideruar inteligjent në nivele mbi mesataren, sërish nuk arrin të "mposhtë" inteligjencën e një kompjuteri, i cili ka në databazë informacione sa për mijëra njerëz inteligjentë, atëherë, kompjuteri është në funksion dhe në ndihmë të njeriut, apo dalë ngadalë po e nxjerr "jashtë funksioni" shumicën e njerëzimit...

Kërcënimin real i mundshëm i teknologjisë së AI-së nuk vjen nga robotët, por përkundrazi vjen nga kushdo që i zhvillon ato. Kjo tregon edhe arsyen pse njerëzit kanë frikë nga AI, dhe mendimet që njerëzit i frikësojnë më së shumti janë se: makineritë do të bëhen më inteligjente se njerëzit dhe do të bashkohen për të na shkatërruar dhe, kur vihet në duar të gabuara, inteligjenca artificiale mund të përdoret për qëllime të liga, të cilat ne do të jemi të pafuqishëm t'i mposhtim.

Megjithatë, këto janë disa nga dyshimet dhe frikërat që ngjallin këto zhvillime jashtëzakonisht shumë të shpejta. Sigurisht që të mirat që sjell për njerëzimin janë të pamasa.

Ray Kurzweil, Drejtori i Inxhinierisë së Google, është një futurist i njohur me një histori të njohur për parashikime të sakta. Nga 147 parashikimet e tij që nga vitet 1990, Kurzweil pretendon një normë saktësie prej 86 për qind.

Në vitin 2017, ai shprehej: "Ne do të kemi më shumë neokorteks, do të jemi më argëtues, do të jemi më të mirë në muzikë... Ne do të shpalosim të gjitha gjërat që vlerat dhe inteligjencën e njeriut, por të shumëfishuar në një shkallë më të madhe." Kur vihet në këto terma, AI nuk tingëllon si një gjë aq e keqe apo e frikshme.

"Viti 2029 është koha e qëndrueshme që unë kam parashikuar, kur një AI do të kalojë një test të vlefshëm "Turing" dhe për këtë arsye do të arrijë nivele njerëzore të inteligjencës. Unë kam caktuar vitin 2045 për "Singularitetin" që do të thotë, është koha kur ne do ta shumëfishojmë inteligjencën tonë efektive një miliardë herë, duke u bashkuar me inteligjencën që kemi krijuar", - shprehet ai.

"Kjo çon që kompjuterët të kenë inteligjencë njerëzore, do ti përdorim ata duke i vendosur brenda trupit tonë,



duke i lidhur me cloud, duke zgjeruar atë që jemi. Sot, ky nuk është vetëm një skenar i së ardhmes, - tha Kurzweil, - është këtu, pjesërisht dhe do të përshpejtohet". Ndërkohë, këto deklarata të tij, aq sa na entuziazmojnë, po aq na fusin tmerrin. Vërtetë, nëse ne arrijmë të integrojmë në trurin tonë inteligjencën artificiale, ekziston mundësia e kundërt: Do ta shfrytëzojmë, apo do të na shfrytëzojë?

"Ajo që në të vërtetë po ndodh është se (makinat) po na fuqizojnë të gjithëve", - thotë Kurzweil. "Ato po na bëjnë më të zgjuar. Ato mund të mos jenë ende brenda trupit tonë, por deri në vitet 2030 ne do të lidhim neokorteksin tonë, pjesën e trurit tonë ku ne mendojmë, me cloud-in (renë)".

Por si do të ndikojë konkretisht në fusha të ndryshme AI?

Inteligjenca artificiale po sjell ndryshime drastike në fushat teknologjike, ku mund të zbatohet për të automatizuar sistemin për më shumë efikasitet dhe performancë. AI tani po përdoret në shumë fusha, nga telefoni celular deri te diagnostikimi i sëmundjeve, duke siguruar një funksionim të lartë, të saktë dhe me efikasitet të sistemit. Por disa nga hapësirat më të rëndësishme ku AI ka gjetur përdorim janë mbrojtja, shëndetësia dhe arsimit.

AI në fushën e mbrojtjes

Inteligjenca artificiale po luan një rol të rëndësishëm në luftën ushtarake. Për shkak të kësaj, disa aplikacione të AI-së tashmë janë duke u zhvilluar nga SHBA-të dhe vende të tjera për përdorime të ndryshme ushtarake.

Krahasuar me sistemet konvencionale, sistemet ushtarake të fuqizuara nga AI mund të menaxhojnë më mirë dhe në mënyrë efikase vëllimin e madh të të dhënave. Për shkak se AI është kaq e mirë në marrjen e vendimeve, ajo rrit në mënyrë të theksuar vetë-rregullimin, vetëkontrollin dhe vetë-aktivizimin e sistemeve luftarake.

Inteligjenca artificiale përdoret pothuajse në të gjitha aplikacionet ushtarake dhe parashikohet që rritja e fondeve për kërkimin dhe zhvillimin nga agjencitë kërkimore ushtarake, për të krijuar përdorime të reja dhe të avancuara të inteligjencës artificiale, do të çojë në një rritje të përdorimit të sistemeve të drejtuara nga AI në Ushtri.

Ka disa efekte pozitive që rrjedhin

nga përdorimi i inteligjencës artificiale në ushtri: Vendimmarrje strategjike; Analizat të sakta dhe të shpejta të skenarëve; Parashikime neutralizuese; Vepër të arsyeshme në rrethana urgjente; Trajnim; Udhëzim të individualizuar; Vlerësime të drejta; Promovime; Realizëm më i madh në simulime dhe stërvitje; Modele kompjuterike të besueshme të teknologjisë në zhvillim; Operacionet ushtarake; Përpunimi efikas i të dhënave nga burime të ndryshme; Detyrat administrative bëhen më të lehta me logjistikën proaktive; Rreziqe të reduktuara për trupat falë logjistikës autonome; Përmirësim i sistemeve mbështetëse; Siguri kibernetike më të lartë; Transport më të lehtë e më të shpejtë; ndikon në kujdesin për viktimat dhe evakuimin; Tanke të automatizuar; Përmirëson shërbimet me dron; Kontrolli më efikas i spiunëve; Redukton punën e njeriut, përmirëson rekrutimet, etj.

Me ardhjen e AI në mbrojtje, shumë sektorë janë përmirësuar si siguria kibernetike, specifikimi i objektivit dhe sistemet RADAR dhe SONAR. Megjithatë, asnjë makineri nuk është aq e aftë të zëvendësojë njerëzit, veçanërisht në pikat e ndjeshme siç janë kufijtë e vendit.

Gjithashtu kostoja e zbatimit të AI në mbrojtje është mjaft e lartë. Inteligjenca artificiale mund të jetë e frytshme në mbrojtje vetëm kur kombinohet me aftësitë dhe teknikat luftarake njerëzore.

Ndikimi i Inteligjencës Artificiale në mjekësi

Një nga fushat ku AI-ja ka gjetur përdorim shumë të vyer për njeriun është Mjekësia.

Sistemet kompjuterike të inteligjencës artificiale përdoren gjerësisht në shkencat mjekësore. Aplikimet e zakonshme përfshijnë diagnostikimin e pacientëve, zbulimin dhe zhvillimin e barnave, përmirësimin e komunikimit midis mjekut dhe pacientit, transkriptimin e dokumenteve mjekësore, të tilla si recetat dhe trajtimin e pacientëve në distancë. Ndërsa sistemet kompjuterike shpesh ekzekutojnë detyrat në mënyrë më efikase se njerëzit, kohët e fundit, algoritmet kompjuterike më të fundit kanë arritur saktësi që janë në të njëjtin nivel me ekspertët njerëzorë në fushën e shkencave mjekësore.

AI do të jetë në gjendje të avancojë sektorin e kujdesit shëndetësor në mënyrë të ndryshme, jo vetëm për diagnostikimin e pacientit, prognozën e pacientit, zbulimin e barnave, por edhe për të shërbyer si një asistent për mjekun dhe për të ofruar një përvojë më të mirë dhe më të personalizuar për pacientët. Kjo shpresë është ushqyer nga disa aplikime të suksesshme të AI-së në kujdesin shëndetësor. Megjithatë, krahas kësaj ka pritsmëri jorealiste se çfarë mund të bëjë AI-së dhe si do të duket peizazhi i industrisë së kujdesit shëndetësor në të ardhmen.

AI në Arsim

Inteligjenca Artificiale ka potencialin për të adresuar disa nga sfidat më të mëdha në arsim sot, duke inovuar praktikatat e mësimdhënies dhe të të mësuarit. Megjithatë, zhvillimet e shpejta teknologjike sjellin në mënyrë të pashmangshme rreziqe dhe sfida të shumta, të cilat deri më tani kanë tejkaluar debatet e politikave dhe kornizat rregullatore.

Inteligjenca artificiale mund t'i ndihmojë studentët të mësojnë më mirë dhe më shpejt, kur shoqërohet me materiale mësimore dhe udhëzime me cilësi të lartë. Sistemet e AI-së gjithashtu mund t'i ndihmojnë studentët të kthehen në rrugën e duhur më shpejt, duke paralajmëruar mësuesit për problemet që syri i lirë nuk mund t'i shohë. Në disa raste, siç është vlerësimi i automatizuar i esesë, mësuesit dhe studentët nuk i përjetojnë drejtpërdrejt përfitimet e mjeteve.

Përkundrazi, shteti i vlerëson provimet në një mënyrë më të shpejtë dhe më efikase. Në raste të tjera, mësuesit janë përfitues të drejtpërdrejtë. Studiuesit, si Scott Crossley në Universitetin Shtetëror të Xhorxhias, po eksperimentojnë me mënyrat se si vlerësimet e bazuara në përpunimin e gjuhës natyrore mund të përfshihen në programet e shkrimit, në mënyrë që mësuesit të mund të marrin raporte të dhënash mbi cilësinë e shkrimit të studentëve të tyre.

Pavarësisht këtyre përfitimeve, ka shqetësime të qarta. Një çështje kryesore është rreth privatësisë. Si e mbrojnë këto mjete privatësinë e përdoruesit? Si e fitojnë shkollat pëlqimin e nxënësve dhe prindërve gjatë prezantimit të asaj që përfaqëson secila shkollë në dallim me të tjerat? A duhet të ndahen të dhënat që janë anonimizuara me studiuesit dhe grupet e tjera të jashtme? Ekspertët theksojnë gjithashtu parajgjetimet si një pengesë e AI-së. Rezultatet e vlerësimeve nga makinat do të bazohen në rezultatet e mijëra testeve. Por, rezultatet e testit mund të pasqyrojnë më shpesh mungesën e mundësive për disponimin e informacionit sesa mungesën e aftësisë. Vlerësimi i makinës nuk do të jetë në gjendje t'i bëjë këto dallime.

Një çështje tjetër është vlera e lidhjeve sociale dhe emocionale dhe vetë përvoja njerëzore e edukimit. E thënë thjesht, AI nuk do t'i zëvendësojë mësuesit.

Disa fusha ose industri të tjera

ku AI po luan një rol të rëndësishëm, duke i ndihmuar njerëzit të punojnë me performancë dhe efikasitet më të mirë pa ndihmën e njerëzve janë: Asistenti Virtual ose Chatbots; bujqësi; fluturimi autonom; Shitja me pakicë, blerje dhe modë; Siguria dhe Mbikëqyrja; Analiza dhe aktivitete sportive; Prodhimi; Menaxhimi i aksioneve të gjalla dhe inventarit; Makina që drejtojnë vetë ose automjete autonome; Magazinimi dhe Zinxhiri i Furnizimit Logjistik etj.

Por në të gjitha fushat ku AI ka gjetur përdorim ka edhe të meta si:

- Kostoja e lartë e zbatimit, riparimi dhe mirëmbajtja kushtojnë gjithashtu.

- Programet e softuerit me bazë artificiale kërkojnë përmirësim të shpeshta, në mënyrë që t'u shërbejnë kërkesave të mjedisit në ndryshim pasi makina duhet të bëhet më e zgjuar dita ditës;

- Nuk përmirësohet me përvojë. Një nga vetitë e rëndësishme të fuqisë logjike të njeriut është aftësia e tij për t'u zhvilluar me përvojën dhe moshën. Pra, e njëjta gjë nuk mund të jetë e vërtetë për AI-të, pasi ato nuk mund të zhvillohen kështu sepse janë makina. Me kalimin e kohës, ato fillojnë të konsumohen.

- Kompjuterët nuk mund të ndryshojnë reagimin e tyre ndaj mjediseve në ndryshim. Kjo është gjëja bazë mbi të cilën janë ndërtuar AI: natyra e përsëritur e punës ku inputi nuk mund të ndryshohet. Sa herë që ka ndryshim në të dhëna, atëherë AI-të duhet të riveletohen, rikualifikohen dhe rindërtohen, dhe ky është gjithmonë një proces që duhet kryer nga njeriu;

- Gjithashtu, makinat nuk mund të vendosin ose të bëjnë dallimin midis të drejtës ose të gabuarës, sepse ato nuk janë në gjendje të kuptojnë konceptin e etikës ose të ligjit.

- I mungon kreativiteti. Inteligjenca artificiale nuk është ndërtuar për punë krijuese, kështu që është e qartë se imagjinata ose kreativiteti nuk janë për inteligjencën artificiale, sepse ato janë makina. Inteligjenca artificiale mund t'ju ndihmojë të krijoni diçka të veçantë, por ato ende nuk mund të konkurrojnë me trurin e njeriut.

Një gjë që duhet mbajtur parasysh me inteligjencën artificiale është se kompjuterët, madje edhe ata që arrijnë AI të Përgjithshme, do të mbështeten ende te njerëzit për t'i programuar ato.

Inteligjenca artificiale do të mësojë se si programuesit e informacionit i filtrojnë ato. Kjo është qetësuese për sa kohë që programuesit po veprojnë në interesin më të mirë të shoqërisë njerëzore. Kompjuterët dhe makinat mbështeten në ndihmën e njerëzve sepse nuk kanë njohuri të pafundme. Ata kanë nevojë që ne t'i programojmë dhe t'u themi se çfarë të mendojnë dhe si të veprojnë.

Ne shqetësohemi për humbjen e kontrollit mbi aspekte të ndryshme të jetës sonë. Në fund të fundit, ne jemi qenie autonome që vlerësojmë konceptet e mendimit të pavarur dhe lirisë për të marrë vendime dhe për të ndërmarrë veprime. Jemi të ndryshëm, nuk jemi të programuar të reagojmë njësoj...

Dita Ndërkombëtare e Gruas 2023: BE-ja merr vendime historike, por të drejtat e grave janë nën sulm globalisht

Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë bënë deklaratën e mëposhtme: “Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, ne mendojmë për qëndrueshmërinë dhe forcën e grave; Vendosmëria e tyre për të dalë kundër padrejtësisë; Përkushtimi i tyre për të mbrojtur të tjerët; Përpjekja e tyre e pandërprerë për ndryshim.

Jo vetëm sot, por çdo ditë, ne qëndrojmë të bashkuar me të gjitha gratë për të ndërtuar vrull për të drejtat e tyre në mbarë globin. Ne duam t'i fuqizojmë gratë që të ndjekin qëllimet e tyre të jetës pa pengesa.

Shtypja në rritje globale ndaj grave dhe vajzave dhe sulmet ndaj të drejtave të tyre njerëzore janë alarmante.

Ne qëndrojmë pranë grave në Iran, liritë e të cilave janë të kufizuara sistematikisht; dhe ato në Afganistan, ku talebanët po përpiqen të fshijnë praninë e grave dhe vajzave nga hapësira publike, si dhe kudo tjetër në botë ku të drejtat dhe liritë themelore të grave kërcënohen ose mohohen.

Ne jemi gjithashtu thellësisht të shqetësuar për raportet se Forcat e Armatosura Ruse përdorin dhunën seksuale ndaj grave dhe fëmijëve në Ukrainë si një armë lufte. Këto veprime përbëjnë krime lufte dhe autorët duhet të sillen para drejtësisë. Ne do të vazhdojmë të punojmë me partnerët tanë ndërkombëtarë për ta bërë Rusinë të paguajë për këto mizori.”



Për të forcuar përgjegjshmërinë globale, BE sapo ka miratuar një paketë sanksionesh kundër autorëve të dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore.

Ka edhe një lajm të mirë. BE-ja ka marrë vendime historike për të siguruar që gratë në BE të kenë të njëjtat mundësi si burrat. Për shembull, me rregullat e reja të BE-së për balancën gjinore në bordet e korporatave ose transparencën

e pagave. Ne duam gjithashtu të vendosim rregulla në mbarë BE-në për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje.

“Ka më shumë punë për të bërë. Të drejtat reale të barabarta janë ende shumë larg. Barazia gjinore do të arrihet vetëm në ditën kur ne të gjithë të jemi pjesë e promovimit dhe mbrojtjes së saj, qoftë në BE dhe në botë.”

Gratë dhe droga - Nevoja për të rritur shërbimet me ndjeshmëri gjinore në Evropë

Gratë përbëjnë afërsisht një të katërtën e të gjithë njerëzve me probleme serioze me drogën në Evropë dhe rreth një të pestën e të gjithë personave që hyjnë në trajtimin e drogës. Megjithatë duhet bërë ende shumë për të ofruar ndërhyrje të përshtatura për nevojat e tyre, me shumë shërbime të drogës që mbeten të orientuara nga meshkujt.

Këto çështje janë eksploruar nga agjencia e BE-së për drogat (EMCDDA), në Ditën Ndërkombëtare të Gruas (8 Mars), në një mini-udhëzues të ri “Gratë dhe drogat: Shëndeti dhe Përgjigjet Sociale”. Udhëzuesi përshkruan konsideratat kryesore për planifikimin dhe dhënien e përgjigjeve shëndetësore dhe sociale për këtë grup, rishikon disponueshmërinë dhe efektivitetin e shërbimeve ekzistuese dhe eksploron implikimet për politikën dhe praktikën.

Në BE, vlerësohet se mbi 30 milionë gra (dhe 50 milionë burra) (15-64 vjeç) kanë provuar një drogë të paligjshme në një moment të jetës së tyre. Gratë dhe burrat me probleme droge ndryshojnë në karakteristikat e tyre sociale, kushtet e jetesës dhe modelet e përdorimit të drogës, në pasojat e përdorimit të tyre të substancave dhe në përparimin drejt varësisë.

Gratë që përdorin drogë, për shembull, kanë veçanërisht të ngjarë të përjetojnë stigmë dhe disavantazh ekonomik, vijnë nga familje me probleme të përdorimit të substancave,

kanë përgjegjësi për kujdesin e fëmijëve, janë viktime të abuzimit në fëmijëri ose vuajnë nga çrregullime mendore që ndodhin bashkë. Edhe pse gratë paraqesin shqetësime unike që lidhen me seksin dhe gjininë, ekziston rreziku që programet për gratë të privohen nga prioriteti kur ka fonde të kufizuara.

“Çështjet komplekse dhe të mbivendosura me të cilat përballen shumë gra që përdorin drogë, kërkojnë shërbime të koordinuara dhe të integruara. Në të gjithë Evropën, përdorimi i drogës, rrjetet e shëndetit mendor dhe shërbimet sociale shpesh

janë të ndara”, - thuhet në udhëzues. Ai shton: “Përshtatja e një qasjeje të përgjegjshme gjinore ndaj problemeve të drogës përfiton njerëz të ndryshëm gjinor, duke përfshirë gratë, burrat dhe njerëzit transgjimorë dhe jobinarë”.

Sipas udhëzuesit, nevojat e grave duhet të merren parasysh dhe të përfshihen në të gjitha aspektet e dizajnit dhe ofrimit të shërbimeve. Përfshirja e grave në planifikimin dhe zhvillimin e politikave dhe programeve përkatëse mund të përmirësojë shërbimet dhe të rrisë shtrirjen e tyre. Udhëzuesi kërkon: trajnimin e stafit në

Qendra Ndërkombëtare për Ndjekjen e Krimit të Agresionit u zyrtarizua në Konferencën e Bashkuar për Drejtësi në Ukrainë

Autoritetet ukrainase organizuan Konferencën e Bashkuar për Drejtësi nga 3-5 mars në qytetin e Lviv, duke bashkuar një numër të madh aktorësh të përfshirë në përpjekjet për të garantuar përgjegjësinë për krimet thelbësore ndërkombëtare që dyshohet se janë kryer në Ukrainë. Si rezultat kyç i konferencës, shtatë vendet partnere të ekipit të përbashkët hetimor (JIT) të mbështetur nga Eurojust vendosën të ndryshojnë marrëveshjen ndërmjet tyre, në mënyrë që të pasqyrojnë rolin e ardhshëm të Qendrës Ndërkombëtare për Ndjekjen e Krimit të Agresionit (ICPA).

Harta e UKRAINËS ICPA do të jetë pjesë e strukturës ekzistuese mbështetëse për EPH, me fokus të veçantë në mbështetjen dhe zgjerimin e hetimeve për krimin e agresionit. Ndryshimet aktuale në marrëveshjen e JIT zyrtarizojnë rolin e Eurojust-it në mbështetje të ICPA-së dhe specifikojnë se vendet partnere të EPH mund të përfitojnë nga mbështetja shtesë logjistike, financiare dhe operacionale që ofron.

Si pjesëmarrëse e EPH-së, Zyra e Prokurorit (OTP) e Gjykatës Ndërkombëtare Penale mund të marrë pjesë në bashkëpunim nëpërmjet ICPA-së kur plotësohen disa kushte. Tani që ICPA është zyrtarisht pjesë e marrëveshjes EPH, Eurojust do të vazhdojë me zbatimin praktik. Blloqet kryesore të ndërtimit pritet të jenë në vend deri në verë. Anëtarët e JIT, OTP dhe Eurojust do të vazhdojnë bashkëpunimin e tyre të qetë në lidhje me hetimet e vazhdueshme për krimet e dyshuara thelbësore ndërkombëtare në Ukrainë.

Duke komentuar marrëveshjen e rishikuar të JIT, Presidenti i Eurojust, z. Ladislav Hamran tha: “Këto ndryshime janë një moment historik vendimtar në procesin e krijimit të ICPA. Ato pasqyrojnë ambicien e të gjithë partnerëve të EPH për të adresuar hendekun e mosndëshkimit dhe për t'i dhënë Eurojust-it një bazë ligjore solide për të vazhduar me zbatimin praktik sa më shpejt të jetë e mundur. Fakti që amendamentet u ranë dakord gjatë një konference kaq të rëndësishme në Lviv është një simbol i angazhimit tonë të vazhdueshëm për të garantuar drejtësi për popullin ukrainas”.

Konferenca e Bashkuar për Drejtësi shënoi gjithashtu nisjen zyrtare të Grupit të Dialogut të Përgjegjshmërisë në Ukrainë, që synon promovimin e dialogut dhe koherencës në të gjithë gamën e ndryshme të nismave të llogaridhënies që janë aktualisht në lëvizje. Vendimi për krijimin e Grupit të Dialogut u mor nga 45 vende në Konferencën e Përgjegjshmërisë së Ukrainës, të mbajtur në Hagë më 14 korrik të vitit të kaluar. Së bashku me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Ukrainës, Eurojust do të bashkëkryesojë një rrjedhë pune mbi hetimet kombëtare me synimin për të identifikuar sfidat kryesore me të cilat përballen çështjet kryesore të krimit ndërkombëtar dhe të propozojë së bashku zgjidhje në nivel politikash.

Konferenca u hap zyrtarisht nga Presidenti ukrainas z. Volodymyr Zelenskyy, si dhe nga një video-mesazh i Presidentes së Komisionit Evropian zonja Ursula von der Leyen, dhe në mesin e pjesëmarrësve ish-in Prokurori i Përgjithshëm i Ukrainës z. Andriy Kostin, komisioneri Evropian për Drejtësi z. Didier Reynders dhe Prokurori i Gjykatës Penale Ndërkombëtare z. Karim A. A. Khan QC.



shërbimet shëndetësore dhe sociale për të ofruar ndihmën e duhur (jo gjyquese, empatike), krijimin e mjediseve të sigurta për të lehtësuar aksesin e grave në kujdes dhe shërbime të përgjegjshme ndaj gjinisë dhe të informuara për traumat.

Ekziston një nevojë urgjente për kërkime që trajtojnë çështjet gjinore dhe marrin parasysh gjininë në të gjitha aspektet e dizajnit të shërbimit. Më shumë kërkime mbi vlerësimin efektiv të qasjeve që u përgjigjen nevojave të grave që përdorin drogë janë gjithashtu të një rëndësie kyçe. Përfshirja e

ndarjeve sipas gjinisë në mbledhjen rutinë të të dhënave statistikore mund të përmirësojë të kuptuarit e tendencave të përdorimit të drogës, faktorëve sociodemografikë dhe çështjeve me të cilat përballen gratë brenda një rajoni të caktuar. Ky është një hap vendimtar në zhvillimin e përgjigjeve të përshtatshme.


Si përmbledhje, e vetmja mënyrë e adekuate për të përmbushur nevojat e ndryshme dhe komplekse të grave që përdorin drogë është përmes një qasjeje të përgjegjshme gjinore e bazuar në shërbimet e integruara.

'Kush ka vdekur për Atdhe, nuk ka vdekur por ka le'

RRETHIMI I FUNDIT I ADEM JASHARIT, MË 05 MARS 1998, DHE KTHIMI NË LEGJENDË DHE PËRJETËSI

Adem Jashari ishte kryekomandanti dhe themeluesi kryesor i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së). Lindi më 28 nëntor 1955, në fshatin Prekaz të Poshtëm të Drenicës, Kosovë, dhe ra dëshmor, më 7 mars 1998, në të njëjtin fshat, gjatë Sulmit në Prekaz. Pas luftës, ai u shpall Hero i Kosovës. Së bashku me vëllain e tij Hamzën, Adem Jashari ka marrë pjesë në sulmet kundër forcave policore-ushtarake serbe, të cilët më vonë e sulmuan shtëpinë e tij në mars të vitit 1998, ku Adem Jashari ra heroikisht së bashku me 58 anëtarët e familjes së tij. Ky është rast unik në historinë e luftërave. Ai njihet si "Komandanti Legjendar i UÇK-së". Urdhri "Hero i Kosovës" iu dha atij në vitin 2008 nga Kryeministri i Kosovës. Adem Jashari lindi në një familje me traditë patriotike. Ishte djali i tretë i mësuesit Shaban Jashari.

Shkollën fillore e përfundoi në vendlindje, ndërsa Shkollën e Mesme Teknike e përfundoi në qytetin e Skenderajt. Adem Jashari gjithmonë ishte i vetëdijshëm se vetëm krisma e pushkës do ta çlironte Kosovën nga okupimi serbo-sllav. Rrallëherë e shihje pa armë. Ai ishte rritur në frymën e trimërisë, heroizmit dhe atdhedashurisë, nga e cila ia kishte mbjellë heroizmin babai i tij Shabani. Në vitin 1991, Adem Jashari u zhvendos në Shqipëri sipas marrëveshjes së autoriteteve kosovare me Ramiz Alinë, për t'u trajnuar me vullnetarët e parë, që më vonë u bashkuan në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Më 28 shkurt 1998, një grup luftëtarësh të udhëhequr nga Adem Jashari, sulmuan patrullat e policisë serbe, duke vrarë katër policë dhe plagosur dy. Familjen Jashari e luftuan forcat serbo-sllave në Kosovë, në vitet e '90, por ky fakt u mbajt i fshehur nga opinioni i gjerë, nga ana e politikanëve të moderuar shqiptarë dhe nga qeveria e Beogradit, si mënyrë për të ruajtur status-kuonë. Beteja e parë mes Ademit dhe shokëve të tij kundër Forcave Federale Jugosllave u bë në mëngjesin e 30 dhjetorit të vitit 1991. Shtëpia e Jasharajve ishte rrethuar nga një numër i madh i forcave të sigurimit



serbo-sllav, duke kërkuar dorëzimin e tij. Adem Jashari së bashku me shokët e tij, e thyen rrethimin dhe më vonë morën pjesë në disa aksione kundër ushtrisë jugosllave dhe policisë. Shtëpia e Adem Jasharit në Prekaz u sulmua përsëri nga forcat e policisë federale jugosllave, më 22 janar të vitit 1998. Sulmi u përballua përsëri me sukses.

Sulmi i parë ndaj Familjes Jashari

Më 30 dhjetor 1991, forca të mëdha policore serbe, të mbështetura edhe nga forcat ushtarake jugosllave, rrethuan shtëpinë e Shaban Jasharit në Prekaz. Sigurimi Shtetëror Serb ishte në dijeni për arritjen e këtyre luftëtarëve në Prekaz. Në Kullë ndodheshin: Adem Jashari me vëllezërit Rifatin dhe Hamzën dhe me bashkëluftëtarët, Sahit Jashari, Fadil Kodra e me trima

të tjerë të Kodrajve e të Lushtakëve të Prekazit. Përleshja kishte zgjatur prej mëngjesit e deri në orën 15:00 të asaj dite. Trimave të lirisë u kishin shkuar në ndihmë qindra liridashës të tjerë, në mesin e tyre edhe daja i Adem Jasharit, Osman Geci, nga Llausha. Meqenëse bërthamës çlirimtare, në krye të së cilës ishte Adem Jashari, po i arrinin përforcime nga të gjitha anët, forcat serbe u detyruan të tërhiqen. Ato e kishin kuptuar se luftëtarët e lirisë po i mbanin armët për të luftuar kundër tyre. Prej 30 dhjetorit të vitit 1991, Adem Jashari dhe bashkëluftëtarët e tij nuk e ndërprejnë luftën e armatosur kundër pushtuesit serb, deri në çlirimin e Kosovës. Ai edhe ishte i zgjedhuri i trimave dhe asnjë nga shokët nuk e kishte vënë në dyshim asnjëherë pozitën e tij të prijësit. Adem Jashari

tashmë ishte bërë komandant legjitim i formacioneve ushtarake çlirimtare, që më vonë do të quhen UÇK-ja. Ai ishte në dijeni paraprakisht për të gjitha aksionet që ishin kryer kundër forcave serbe në Kosovë, që prej vitit 1991 deri më 1998. Në shumicën e këtyre aksioneve ai kishte marrë pjesë edhe vetë. Gjatë periudhës së viteve 1991-1994, vetëm në Skënderaj e në Drenas, në këto aksione janë vrarë dhjetëra policë. Ndërsa më 23 mars të vitit 1993, me urdhrin e komandantit Adem Jashari, në udhëkryqin e hekurudhës në Drenas, është sulmuar automjeti i policisë serbe, janë vrarë 5 dhe janë plagosur 6 policë serbë. Këtë aksion e kishin kryer Sami Lushtaku, Ilaz Kodra dhe Rafet Rama. Gjatë viteve të veprimtarisë ilegale guerile, Adem Jashari ka koordinuar pothuajse të gjitha aksionet që kanë ndodhur, jo vetëm në Drenicë, por në mbarë Kosovën. Në vjeshtë të vitit 1994, Shërbimi Sekret Serb zë në befasi dhe e arreston njërin prej bashkëveprimtarëve të Adem Jasharit, Besim Ramën nga Prekazi. Në procesin gjyqësor, të organizuar kundër tij, Gjykata e Qarkut në Prishtinë i

Jashari dhe konfirmuan para faktorit ndërkombëtar, si alternativë të vetme, lëvizjen pacifiste.

Rrethimi i Tretë i Kullës së Jasharajve në Prekaz, më 5, 6 dhe 7 mars 1998

Në orët e para të mëngjesit të 5 marsit 1998, në Prekaz u sulmua sërish familja Jashari nga Ushtria Serbe dhe forcat policore serbe. Forcat sulmuese përbëheshin nga transportues të blinduar dhe pjesëtarë të policisë, të mbështetur nga artileria nga një fabrikë municioni në afërsi. Lagjen Jashari e kishin rrethuar me 100 policë serbë. Sulmi zgjati 3 ditë dhe 2 net.

Forcat Serbe filluan sulmin pa asnjë paralajmërim. Pas kësaj kanë filluar të shtënat e automatikëve dhe mitralozave. Nga një shtëpi, policia serbe qëllonte me mortaja, pasuar nga gazi lotsjellës. Shumica e familjes së gjerë të Jasharajve u mblodhën në një dhomë të vetme, e cila ishte e murosuar me tulla. Një predhë pastaj ra përmes çatisë, duke vrarë një numër të anëtarëve të familjes. Granatimet e vazhdueshme për 52 orë ia mundësuan policisë më në fund të



Kulla dhe shtëpia e Adem Jasharit, të shkatërruara gjatë Sulmit në Prekaz

dënoi prej 6 deri në 20 vjet burg: Adem Jasharin, Besim Ramën, Ilaz Kodrën, Hashim Thaçin, Rexhep Selimin, Fadil Kodrën, Zenun Kodrën, Nuredin Lushtakun, Sami Lushtakun, Sahit Jasharin, Idriz Asllanin, Ali Jonuzin dhe Jakup Nurën. Adem Jashari u dënua me 20 vjet burg në mungesë. Për aktivitetin luftarak, qëllimin e Adem Jasharit dhe të bërthamës së tij çlirimtare, e dinin edhe politikanët pacifistë shqiptarë, të cilët këto zhvillime i përcillnin me skepticizëm dhe mosbesim. Kishte edhe raste kur aktiviteti i tij interpretohej me dubioza të liga dhe me kualifikime antikombëtare. Prania e grupeve të armatosura ilegale në Kosovë, në gjysmën e dytë të viteve '90, shkaktoi konfuzione të caktuara në rrjedhat politike. Të gjithë kryetarët e partive politike pacifiste, pa dallim, u distancuan nga aktiviteti ushtarak i këtyre grupeve çlirimtare të udhëhequra nga Adem

hyjë në shtëpi.

Sulmi kishte për qëllim eliminimin e të gjithë dëshmitarëve. Adem Jashari së bashku me 56 anëtarët e familjes së tij u vranë. Gjithsej 58 persona janë vrarë, në mesin e tyre 18 ishin gra dhe 10 fëmijë nën moshën 16-vjeçare. Këtij sulmi i mbijetoi vetëm vajza e vogël e familjes, Besarta Jashari, e cila asokohe ishte vetëm 11-vjeçare.

Adem Jashari dhe sakrificat e tij heroike u bë simboli i pavarësisë për shqiptarët e Kosovës dhe për shqiptarët kudo që janë. Kështu, shumë prej tyre veshën bluza me fotografinë e tij pasi Kosova shpalli pavarësinë e saj të dielën, më 17 shkurt të vitit 2008. Mbishkrimi në bluzat ishte "Bac u kry", duke iu referuar shprehjes së përdorur gjatë homazheve në varrin e tij me rastin e shpalljes së pavarësisë, si realizim i qëllimit sublim të të gjithë jetës dhe veprimtarisë së Adem Jasharit.

Të përjetshëm dëshmorët e atdheut!



Zëri i ëmbël i mësuesve, që ende kumbon në veshë

(Në kuadrin e Ditës Kombëtare të Mësuesit)



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Gjylizare Çiço, mësuesja e virtyshme

Gjylizare Çiço ka mbetur legjendë e arsimit në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”. Ajo, siç janë shprehur në vite nxënësit e saj të shumtë, ishte një edukatore e mrekullueshme, këmbëngulëse në kërkesën e llogarisë, e dashur, profesioniste, fisnike. Kështu ishte ajo, që ende e re, kur nisi të mësojë lëndën e letërsisë, por mbi të gjitha të qenit njeri, me skënderbegasit e parë të ardhur nga fronti i luftës, në gati katër dekada mësimdhënie, kur doli në pension, deri kur u nda fizikisht nga jeta. Por ajo rron në zemrat e brezave që patën fatin të jenë nxënës të saj...

Mësuese Gjylizare pati kohën e vet për të jetuar, dhe në këtë kohë ajo ngriti lart me vepra emrin e saj si mësuese, duke arritur deri tek virtyti. Që mësuese e re dhe deri sa doli në pension, duke punuar vetëm në këtë shkollë të lavdishme, me zgjuarsinë, energjinë, kulturën dhe pasionin e saj, shpjegonte bukurinë e gjuhës shqipe dhe magjinë e letërsisë. Pikërisht për këto cilësi të jashtëzakonshme e deshëm me gjithë zemër skënderbegasit, siç deshëm nënat tona që në atë kohë i kishim larg. Ndofta në emër të asaj armate djemsh të mrekullueshëm që të edukuar dhe të mësuar prej mësuesve të papërsëritshëm si ajo, i shërbyem me devocion dhe ndershmëri Atdheut.

Zëri i mësuesve na kumbon në veshë dhe sot. Ajo që mësuesit patën për kryefjalë dhe falë së cilës, nga duart e tyre, nga erudicioni i tyre, nga takti tyre i lartë pedagogjik, nga dashamirësia e tyre, dolën jo vetëm një pafundësi kuadrosh - qytetarë të dorës së parë, por edhe qindra e qindra kuadro të devotshëm për Atdheun. Dhe jo vetëm ata mburren përherë me mësuesit e tyre, por edhe Shqipëria u detyrohet njerëzve të tillë edhe pse vetë ata e privuan veten nga shumë gjëra, për këtë qëllim kaq fisnik. Në solemnitetin e këtij çasti, të Ditës Kombëtare të Mësuesit, sado dhe sido që ta vrasim mendjen, duke kujtuar mësimet e mësuesit, them se vetëm dhe vetëm pasionet e mëdha mund ta lartësojnë shpirtin për vepra të mëdha. Gjylizare Çiço, siç shprehen edhe sot mjaft skënderbegas, shpjegonte me pasion mësimin dhe iu thoshte atyre: “lexoni, në doni të bëheni dhe të mirë dhe të denjë për familjet dhe Atdheun tuaj!”. E mira mësuese Gjylizare, mbeti një shenjto e gjallë, mbeti e tillë, pasi ngriti lart me vepra emrin e saj, duke arritur kështu vetë vertytin. E në këtë ditë të mësuesisë Gjylizarja, nuk harrohet kurrë, buzëqeshja e saj e çiltër ka mbetur e freskët në sytë e mijëra skënderbegasve, ashtu si ndjenjat e saj delikate, kur fliste për bukurinë e jetës dhe forcën e dashurisë njerëzore.

Bejkush Birçe, mësuesi emblema i skënderbegasve

Bejkush Birçe, si rrallë kush ishte talenti i shumë sporteve dhe shkëlqeu në futboll, volejboll, basketboll,



Gjylizare Çiço



Bejkush Birçe



Shkëlqim Dervishi

boks, gjimnastikë, not dhe ka ushtruar veprimtarinë e tij dhe në shah, patinazh, ski dhe atletikë etj. Kjo gjithëpërfshirje flet për një emblema të sportit shqiptar, një enciklopedi sportive modeste. Me mbarimin e shkollës së mesme të fizikut në emërua pedagog në qytetin e Vlorës, ku punoi për një vit si mësues i edukimit fizik dhe pastaj në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”, ku gjatë kësaj periudhe ka punuar me ndërprerje pasi është aktivizuar si trajner futbollit në shumë skuadra të vendit. Përgatitja dhe pajisja me kulturë të gjerë sportive e bashkuar me aftësitë dhe talentin që ia kishte falur natyra, bënë të mundur që gjatë gjithë jetës së tij të shkëlqejë në fusha të sportit si debutues i suksesshëm. Bagazhi i tij sportiv e ka bërë Bejkushin një emblema të sportit shqiptar të nderuar me titullin e lartë “Mjeshtër i Madh”. Skënderbegasit dhe kolegët e tij flasin me shumë admirim për karakterin e tij stoik e të paepur para çdo trysnie të kohës, për ndershmërinë brilante pa asnjë kompromis e joshje koniunkturale, për modestinë dhe talentin e veçantë, që i ka dhënë krahe sportit shqiptar. Emri dhe vepra e Bejkush Birçes, e mësuesit shumë-dimensional ka qenë dhe do mbetet një medaljon krenarie në gjoks të sportit shqiptar, në të gjitha kohërat.

Shkëlqim Dervishi, drejtori i fundit i shkollës...

28 mars 1945, ishte një ditë e paharruar dhe e shënuar, ditë historike në kujtesën e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Në këto ditë të trazuar do të çelte dyert Shkolla e Pionierëve të Luftës, me 200 partizanë të vegjël,

midis të cilëve dhe 7 vajza. Komandanti i parë i shkollës, Dule Pashaj, do të thërriste një staf të zgjedhur mësuesish e komanduesish, me të cilët do të shkruante historinë e ditëve dhe të viteve të para të shkollës.

Mësues Shkëlqim Dervishaj do të tregonte se në fillesat e para të saj ajo nuk kishte bazë materiale mësimore, as kabinete e laboratorë. Por falë punës pasionante e këmbëngulëse të oficerëve e mësuesve, ajo do të modernizohej gjithmonë e më tepër. Programi arsimor i shkollës realizonte ndërthurjen e arsimit të mesëm me atë të edukimit fizik e ushtarak. Stërvitja ushtarake ishte e planifikuar dhe zhvillohej me intensitet të lartë. Në këtë drejtim, një vend të rëndësishëm zinte përgatitja rreshtore, përgatitja e zjarrit, njohja dhe përdorimi i armëve me të cilat ishte e pajisur ushtria, aftësimi i nxënësve për qitje si dhe përgatitja taktike. Në çdo veprim që kryenin skënderbegasit vihej re një organizim i përsosur ushtarak. Rreshtimi dhe parakalimi çdo ditë të hënë, marshimet pas Malit të Dajtit, pjesëmarrja në stërvitje me trupa, në spartakiada e manifestime, në parada, vizitat në fabrikat e uzinat ushtarake, në regjimentet e Aviacionit e të Flotës Detare, në reparte të tjera ushtarake, formonin dhe shtonin më shumë dashurinë e skënderbegasve për karrierën e tyre ushtarake.

Shkolla Ushtarake “Skënderbej” nuk mund të qëndronte e shkëputur nga problemet e zhvillimit të vendit. Skënderbegasit punuan dhe kontribuan në ndërtimin e veprave të pesëvjeçarëve, në hapjen e rrugëve, në veprat energjetike dhe në ndërtimin

e hekurudhave. Aktivitetet ku mori pjesë Shkolla “Skënderbej” ishin tharja e kënetës së Maliqit në vitin 1950, hapja e tokave të reja në Bize të Martaneshit në vitin 1966, ndërtimi i rrugës së Malësisë së Madhe në vitin 1968, hapja e tarracave për agrume në brigjet e Jonit në Lukovë e Ksamil në vitin 1971, tarraca këto që për vite me radhë do të thirreshin me emrin e shkollës “Skënderbej”, ndërtimi i hekurudhës Librazhd-Përrenjas në sektorin e Qukësit në vitin 1973, etj. Shkolla ka marrë pjesë në mjaft aksione në ndihmë të bujqësisë në fshatrat e Lezhës, Lushnjës e Fierit. Kjo listë e kontributeve të shkollës nuk është e plotë, sepse aktivitetet e saj janë të panumërta. Në vitin 1954 përfundon studimet matura e parë, e cila do të mbahet mend për rezultatet e larta të saj dhe që nga ky vit, skënderbegasit do të kenë mundësi të vazhdojnë studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe më vonë në atë të Marinës e Aviacionit.

Sukseset dhe arritjet e Shkollës “Skënderbej” nuk mund të realizoheshin pa kontributin e pazëvendësueshëm të stafit pedagogjik e ushtarak të shkollës. Atyre iu takon çdo sukses i arritur. Çdo arritje e skënderbegasve e ka bazën tek mësimet që ata morën, nga shkolla e tyre e dashur, nga mësuesit e tyre të mrekullueshëm, të cilët ishin ata më të zgjedhurit në Tiranë e më gjerë. Ata nuk ishin vetëm mësues e pedagogë, por siç thotë populli me tërë kuptimin e fjalës, ata ishin shpirt njeriu, që dinin të administronin me kujdes ndjenjat e nxënësve, ndaj skënderbegasit u

thonë me plot gojën: Faleminderit o njerëz të ditur e të mirë, o prindër të vërtetë për ne!

Në shtator të vitit 1992, shkolla mbylli dyert për nxënësit e saj skënderbegas, ëndrrat e të cilëve u ndërprehen në mes. Drejtori i fundit i shkollës Shkëlqim Dervishaj, mbylljen e shkollës në mënyrë krejt arbitrare e të papritur, pa marrë parasysh mundësitë që krijonin zonat nga vinin nxënësit, për arsimin e mëtejshëm të tyre, e quan një vendim të keq. Në atë vit, drejtori shprehet se nuk mund ta mendonin e as ta besonin se ky monument historik do të etiketohej si shkollë “jenicerësh”, në një kohë kur ishte përgatitur një armatë kuadrosh nga më të diturit e nga më atdhetarët, me kontribute të çmuara në jetën e vendit. Për fat të keq, shumë mendje të çoroditura e dashakeqe, nuk e kanë kuptuar dhe nuk duan të kuptojnë shpirtin e rrallë dhe krejtësisht demokratik të skënderbegasit, ku valon vetëm e përparuar dhe atdhedashuria. Ajo shkollë nuk ekziston më, por askush nuk mund ta errësojë lavdinë e saj. Në fakt, vendi e veçanërisht ushtria, humbën një legjendë, që iu deshën 47 vjet për t’u bërë ikona e arsimit shqiptar, simboli i dijes dhe i kulturës, i edukimit ushtarak dhe atdhetar. Shkolla Ushtarake “Skënderbej” i ka sot dyert e mbyllura dhe nuk mund të hyhet në gjirin e saj. Sot ka një shoqatë e cila ka hapur dyert e dritaret për të gjithë skënderbegasit, mësuesit e oficerët që punuan e kontribuan për ta bërë shkollën elitë të arsimit shqiptar...



5 MUNDËSI PUNËSIMI

PËR EKSPERTË TË SIGURISË
KIBERNETIKE NË NJËSINË
USHTARAKE TË MBROJTJES
KIBERNETIKE

Për më shumë info:
www.mod.gov.al

Njësia Speciale e Sigurisë Kibernetike fton më të mirët të bëhen pjesë e saj! 5 mundësi të reja punësimi, për këdo që ka pasion sigurinë kibernetike dhe dëshiron të jetë pjesë e një ekipi dinamik. Mos e humbisni mundësinë për të për të punuar në këtë njësi, me një pagë absolutisht konkurruese dhe me mundësi kualifikimi në qendrat e ekselencës të NATO-s. Kushtet dhe kriteret i gjeni në linqet e mëposhtme.

Aplikimet mbyllen më **22.03.2023.**

1	https://rb.gy/zs1ejc
2	https://rb.gy/iba03v
3	https://rb.gy/bi4auc
4	https://rb.gy/tcjzk6
5	https://rb.gy/niw7is